



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1059 Prot.

Tiranë, më 07.07.2025

V E N D I M

Nr. 157, Datë 07.07. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.198 Regj, datë 26.09.2024, paraqitur nga ankuesi z. T.M , kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe drejtuesit të institucionit znj.O.M , në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*” dhe “*gjendje arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi z. T.M , parashtron si më poshtë:

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kundërshtim me ligjin, nuk më njohu dy tituj akademikë të marrë në Universitetin e Bernës në Zvicër, përkatësisht Habilitimin dhe Profesorin e Asociuar. Jo vetëm që procesi i njohjes tejkaloi afatet ligjore, por përfaqësuesi i Ministrisë falsifikoi të dhënat që unë kisha dorëzuar, duke kërkuar informacion në një *email* që nuk i përkiste Universitetit të Bernës.

Siç mund ta shihni nga shkëmbimi i komunikimit, pavarësisht arritjeve të mia akademike dhe faktit që dy titujt i kisha marrë në një universitet që renditet ndër 100-150 më të mirët në botë, ata nuk u njësuan. Për më tepër, edhe pse kërkoja emrat e komisionit të njohjes së titujve, pasi kisha informacion që përbëhej nga persona nën ndjekje penale, emrat nuk mu vendosën në dispozicion. Ky vendim është politik, pasi lidhet drejtpërdrejtë me qëndrimet e mia ndaj ministres aktuale të arsimit, znj.O.M , përfshirë denoncimin për plagjiaturën në doktoraturën e saj dhe qëndrimet e mia

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

kritike për rolin e saj ndaj pandemisë si Ministre e Shëndetësisë, si dhe ndaj qeverisë shqiptare për nxjerrjen në pah të plagjiaturave dhe korrupsionit në arsim.

Qëndrimi im për diskriminimin politik, por edhe si i kualifikuar, përforcohet edhe më shumë nga fakti që Ministria e Arsimit ka mbrojtur rektorin aktual të Universitetit të Tiranës, z.A.H , pavarësisht denoncimit zyrtar që bëra në ministri të doktoraturës së tij plagjiaturë. Sipas ligjit në fuqi, nuk mund të konkuronin për rektorë kandidatë të kapur me plagjiaturë në gradat shkencore dhe titujt akademik. Kujtoj, që unë si shkencëtar kam një H-index mbi 52, më shumë se 180 publikime shkencore në revistat më prestigjioze botërore, dhe i listuar në shkencëtarët me më shumë impakt në botë, ndërkohë rektori aktual që mban titullin profesor, jo vetëm ka plagjiaturë, por nuk ka asnjë publikim me faktor impakti, sikurse kërkonte ligji për marrjen e titullit akademik.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri, njohjen e këtij rasti si diskriminim politik dhe si person i mirëarsimuar si dhe ndërmarrjen e nismave ligjore për:

- Shpalljen e konfliktit të interesit të Ministrit të Arsimit në përcaktimin e komisionit që vendos për njohjen e titujve akademik dhe gradave shkencore (Ministri i Arsimit ka një pozicion politik, që cenon funksionimin e pavarur të Qendrës së Shërbimit Arsimor) dhe;
 - Hetimin e problematikës së plagjiaturës në universitete, si dhe shpërdorimin e detyrës nga institucionet përkatëse për shkak të mosveprimit.
- Nëpërmjet *emailit* të datës 28.10.2024, ankuesi plotësoi ankesën me informacione të mëtejshme në lidhje me pretendimin për diskriminim politik, duke parashtruar si vijon:

Pretendimi për diskriminim politik lidhet me pozicionin si ish zëvendës Ministër i Arsimit, një pozicion të cilin e mbajta nga data 31.10.2018 deri më 15.11.2018. Në dorëheqjen time, sikurse e kam shprehur në letrën e dorëheqjes, kam theksuar shqetësimet e mia etike, morale dhe profesionale, si dhe papajtueshmërinë që kam me modelin e punës të aplikuar nga Ministria e Arsimit³, duke qenë një zë publik kundër modelit të keqqeverisjes në arsim.

Ky reagim nuk u mirëprit nga qeveria shqiptare dhe vet Kryeministri i Shqipërisë z. E.R, një muaj pas dorëheqjes sime, më ka ofenduar rëndë në një konferencë për shtyp⁴ me akuza të rreme. Ky ofendim dhe gjuhë agresive u pasua nga një telefonatë në shkurt të vitit 2019, të cilën e kam bërë publike në rrjetet e mia sociale⁵.

Dua të theksoj gjithashtu se, Sekretari i Përgjithshëm aktual, i Ministrisë së Arsimit, z.T, është denoncuar nga unë tek Kryeministri për nxjerrje të informacionit⁶. Z.T është kërkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë të shkarkohet për shkak të moszbatimit të detyrave në lidhje me fondet e

³ <https://www.balkanweb.com/jep-doreheqjen-zv.ministrit-i-arsimit-t-m/>

⁴ <https://www.balkanweb.com/larve-politike-rama-t-m-kerkoi-veture-e-babain-shofer/>

⁵ <https://gazeta-shqip.com/kryesoret/t-m-r-me-mori-ne-telefon-perdori-fjalor-ordiner/>

⁶ <https://lapsi.al/2018/12/11/t-m-hakmerret-ndaj-r-publikon-mesazhet/>

ekselencës⁷. Z.T., siç mund të shihet nga dokumentet që kam dorëzuar, ka qenë i përfshirë në të dyja procedurat, si në njohjen e titujve të mi akademikë, ashtu edhe në shqyrtimin e plagjiaturës së rektorit të Universitetit të Tiranës, z.A.H , dhe dekanëve të Fakultetit të Drejtësisë, znj.D. H.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminim garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1333/1 prot., datë 29.10.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS).

1.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit, depozitoi qëndrimin e saj në lidhje me ankesën nëpërmjet shkresës nr.6854/2 prot., datë 18.11.2024, ku ndër të tjera parashtron:

Me urdhrin nr.113 datë 26.3.2024, të MAS “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.A.K ”, kompetencat e titullarit të MAS, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor i janë deleguar zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.K. .

Sipas urdhrit nr.183, datë 23.4.2024, të MAS “Për një shtesë në urdhrin nr.113, datë 26.3.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.A.K ”, znj.A.K si zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, në ushtrim të kompetencave

⁷ <https://sot.com.al/politike/klsh-kerkon-shkarkimin-e-sekretarit-te-pergijthshem-te-ministrise-se-arsimit-dhe-drejtoreshes-se-buxhetit/>

të deleguara nga titullari i MAS, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është ngarkuar të kryejë dhe detyrën si më poshtë: *“sh) Ndjek dhe nënshkruan njohjen dhe njësimin e titujve akademikë dhe gradave shkencore të fituara jashtë vendit duke përfshirë kryesimin dhe ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG) dhe komisioneve ad-hoc për njohjen e titujve akademikë për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”.”*

Me urdhrin nr.179, datë 18.4.2024, të MAS *“Për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e titujve akademik të fituar jashtë vendit”*, është ngritur Komisioni *AdHoc*, i cili sipas pikës 3 të këtij urdhri duhet të shqyrtonte dokumentacionin e aplikimeve për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, si dhe të nënshkruante procesverbalet përkatëse në përfundim të procedurave të njohjes.

Z.T.M ka aplikuar në portalin *e-albania* dhe nëpërmjet shërbimit postar ka depozituar dosjen përkatëse pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), e cila është protokolluar me nr.4321 prot., datë 11.10.2023.

Z.T.M ka aplikuar për të njohur dhe njësuar diplomën *“Veniam Docendi”* lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin akademik *“Profesor i Asociuar”* lëshuar (me kohë të kufizuar) më 1.12.2020, dhënë në Universitetin e Bernës, Zvicër.

Bazuar në udhëzimin nr.21, datë 15.10.2021, të MAS *“Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”* të ndryshuar (referuar Udhëzimi nr.21/2021, i ndryshuar), Kreu III, pika 7.1, Sektori i Njohjes së Diplomave (SENJOD) në QSHA shërben si Sekretariat Teknik i Komisioneve *AdHoc*.

Në urdhrin nr.179, datë 18.4.2024, të MAS, për ngritjen e Komisionit *AdHoc* për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e titujve akademik të fituar jashtë vendit, në pikat 4 dhe 5 përcaktohet: *“4. Sektori i Njohjes së Diplomave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore shërben Sekretariatit Teknik i Komisionit Ad Hoc. 5. Sekretariatit Teknik ka për detyrë të administrojë, vlerësojë dhe paraqesë në komision dokumentacionin, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.21, datë 15.10.2021, i ndryshuar”*.

SENJOD, në cilësinë e Sekretariatit Teknik, në lidhje me aplikimin e z.T.M ka përgatitur raportin teknik të datës 26.4.2024, në të cilin janë pasqyruar dokumentet e depozituara, si dhe materialet e printuara për të gjitha verifikimet e kryera nga SENJOD. Në faqet 2-3 të raportit pasqyrohet përmbajtja e komunikimeve elektronike ndërmjet SENJOD në QSHA dhe Universitetit të Bernës, Zvicër, si dhe ndërmjet këtij Universiteti dhe z.M. .

Konkretisht QSHA, lidhur me kërkesën e z.M. për të njohur dhe njësuar diplomën *“Veniam Docendi”*, lëshuar më 30.6.2020 dhe titullin akademik *“Profesor i Asociuar”* lëshuar (me kohë të

kufizuar) më 1.12.2020, dhënë nga Universiteti i Bernës Zvicër, i është drejtuar këtij universiteti në datën 16.12.2023, me *email*⁸ duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

- *A është secili nga titujt bashkëngjitur autentik?*
- *Me cilin nivel/shkallë ekuivalentohet Venia Docendi/Privatdozent?*
- *A kanë këta titujt vlefshmëri kombëtare në Zvicër?*
- *A janë të regjistruar në regjistrin kombëtar të titujve akademik në Zvicër?*

QSHA, në adresën elektronike të z.D. S D, në datën 29.2.2024, ka dërguar një *email*⁹, nëpërmjet të cilit pasi shpreh falënderimin për përgjigjen e dërguar për pyetjen e parë kërkon më shumë informacion për verifikimin e titujve të z.M. , duke parashtruar pyetjet që nuk kishin marrë përgjigje:

- *Me cilin nivel/shkallë ekuivalentohet Venia Docendi/Privatdozent?*
- *Tituj (Venia Docendi/Privatdozent and Associated Professor) a kanë vlefshmëri kombëtare në Zvicër? Me fjalë të tjera a mund të përdoren këta tituj në universitete të tjera në Zvicër ose jashtë vendit?, apo janë të kufizuar për përdorim vetëm në Universitetin e Bernës.*

Në kthim-përgjigjen drejtuar QSHA, nga adresa z.D.S D, BKD-AH-AUNI xxxxxxxxxx@be.chn Thu 3/7/2024 5:21 PM citohet: “*Venia Docendi/Privatdozenti*” është niveli i kualifikimit pas nivelit Ph.D/doktoraturë. Është niveli më i lartë i kualifikimit të një karriere universitare. Parakusht është shkrimi i një teze habilitimi, e cila është një veçori e veçantë e universiteteve gjermane dhe universiteteve gjermanishtfolëse në Zvicër. Pas përfundimit me sukses të këtij niveli, mund të përdoret titulli “Privatdozent (PD) si dhe personi mund të aplikojë për titullin profesor në universitet. Dy tituj “Privatdozent dhe Profesor i Asocuar janë vendosur si më poshtë:

- *Titulli “Privatdozent” mund të vazhdojë të mbahet nga mbajtësi pas largimit nga universiteti.*

⁸ Email në anglisht i datës 16.12.2023:

The information should include:

- *Is each of the degree attached authentic;*
- *To what level/degrees is the Venia Docendi/Privatdozent equivalent to?*
- *Does these title have nationwide validity in Switzerland?*
- *Are they registerd in the national register for academic titles in the Switzerland?*

⁹ Email në anglisht i datës 29.02.2024:

Dear D. D

Thanks for your response regarding the title verification of Mr. M..

You have already answered to the ffirst question. For the sake of the recognition procedure I still need to collect more information regarding this titles. So the pending questions are as follows:

The information should include:

- *To what level/degrees is the Venia Docendi/Privatdozent equivalent to?*
- *Do these titles (Venia Docendi/Privatdozent & Associated Professor) have nationwide validity in Switzerland? In other word can these tittles be used by other universities in Switzerland or abroad? Or are the bound only to the University of Bern?*

- *Megjithatë, titulli/funksioni “Profesor i Asociuar” është e lidhur me institucionin dhe nuk mund të përdoret më, pas largimit nga universiteti.”*

Autoritetet e universitetit i kanë kthyer përgjigje z.M. me emailet në datat 28.2.2024 dhe 26.2.2024, në të cilat thuhet:

Emaili i datës 28.2.2024, i përkthyer në shqip: “Jemi të lumtur të konfirmojmë se ju keni të drejtë të mbani titullin profesor të asociuar në Universitetin e Bernës që nga momenti i dhënies së titullit (1 dhjetor 2020) deri më 30 nëntor 2023)”

Email i datës 26.2.2024, i përkthyer në shqip: “Ne i referohemi emaileve tuaja të ndryshme drejtuar Prof.S., Prof.Z. dhe Dr.S. Universiteti flet me një zë dhe korrespondenca kryhet në mënyrë uniforme nëpërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm. Ne konfirmojmë dhënien e vedia docendi dhe të drejtën shoqëruese për të mbajtur titullin e pedagogut privat. Për pozitën e profesorit shoqërues¹⁰ vlen sa vijon: E drejta për të përdorur këtë titull ekziston vetëm gjatë punësimit në Universitetin e Bernës. Ky nuk është rasti. Prandaj ju keni humbur të drejtën për të mbajtur këtë titull.”

Në faqen 3-4 të raportit teknik pasqyrohet qëndrimi i SENJOD lidhur me diplomën dhe titullin e z.M. si më poshtë:

“.....Nisur nga sa u parashtrua më sipër, si dhe referuar dokumenteve të paraqitura, rezulton se z.M. , i është akorduar titulli Prof.Asc. i kushtëzuar në kohë dhe hapësirë; pra zoti M. ka pasur të drejtë ta përdorte titullin Prof.Asc për aq kohë sa ishte i punësuar në Universitetin e Bernës dhe vetëm në këtë universitet.

Ndërsa titulli docent sipas ligjit nr.80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nuk listohet në hierarkinë e gradave dhe të titujve; për rrjedhojë nuk mund të njesohet.

Në datën 25.10.2021 ka hyrë në fuqi udhëzimi nr.21 datë 15.10.2021, i MAS “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademik, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara”.

Udhëzimi nr.21 datë 15.10.2021, në kreun I, pika 6/c “Kriteret që duhet të përmbushë diploma/certifikata profesionale dhe grada shkencore për tu njohur dhe njësuar janë: “germa c-certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës”. Kreu I, vlefshmërisë nuk përmbushet.

Udhëzimi nr.21 datë 15.10.2021, në kreun II, pika 4, Njohja dhe njësimi i gradës shkencore “Doktor” nuk listohet në hierarkinë e gradave dhe të titujve: pra, për rrjedhojë, nuk parashikohet procedurë njohje dhe njësimi për emërtesën “Docent”.

¹⁰ Profesor i asociuar.

Në përfundim të raportit teknik SENJOD, bazuar në ligjin nr.80/2015 dhe Udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar, në lidhje me diplomat e z. M. , ka vërejtur se diplomat e tij nuk përmbushin kriteret për t'u njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni *AdHoc* i Njohjes së Titujve Akademikë në mbledhjen e zhvilluar në datën 26.4.2024, ka marrë në shqyrtim dokumentacionin për dosjet e depozituara nga disa aplikantë për njohjen e titujve akademikë, përfshirë dhe aplikimin dhe dokumentacionin e depozituar nga z. T.M .

Komisioni *AdHoc*, sipas përmbajtjes së procesverbalit nr.3, nr.2857 prot, datë 26.4.2024, i është përcjellë paraprakisht me *email* nga Sekretariati Teknik informacioni i detajuar në formë tabelore dhe raporti teknik përkatës mbi aplikimet për njohjen e titujve akademik të fituar jashtë vendit në mënyrë që ky komision ti vlerësonte aplikimet në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr.21/2021, të ndryshuar.

Komisioni *AdHoc* pas shqyrtimit të dosjeve përfshirë dhe dosjen e aplikimit të z.M. , me procesverbalin nr.3, nr.2587 prot, datë 26.4.2024, në pikën II/1 ka vendosur: *“Të mos njohë Titullin Akademik si më poshtë: T. A. M. , Profesor i Asociuar, Universiteti i Bernës, Zvicër.”*

Komisioni *AdHoc*, në vendimin nr.7, nr.2864 prot., 26.4.2024, pasi ka vlerësuar dosjen e aplikimit z.M. për njohjen e titujve akademik të fituar jashtë vendit të depozituar sikurse ka referuar dhe në procesverbalin nr.3, datë 26.4.2024, ka konstatuar:

“Z. T.M ka paraqitur kërkesën për të njohur dhe njësuar diplomën “Venia Docendi”, lëshuar më 30.6.2020 dhe titullin akademik “Profesor i Asociuar”, lëshuar në 1.12.2020 nga Universiteti i Bernës Zvicër.

Referuar dokumenteve të paraqitur dhe verifikimeve përkatëse të kryera nga SENJOD, rezulton se z.M. i është akorduar titulli akademik Profesor i Asociuar, i kushtëzuar në kohë dhe hapësirë; pra z.M. ka pasur të drejtë të përdorë titullin Profesor i Asociuar, vetëm për kohën që ishte i punësuar në Universitetin e Bernës dhe vetëm në këtë universitet.

Udhëzimi nr.21, datë 15.10.2021 i MAS “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë ë lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara”, të ndryshuar, në kreun I, pika 6/c, “Kriteret që duhet të përmbushë diploma/certifikata profesionale dhe grada shkencore për tu njohur dhe njësuar janë : germa c-certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës. Kriteri i vlefshmërisë nuk përmbushet.

Ndërsa titulli docent sipas ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nuk listohet në hierarkinë e gradave dhe titujve.

Udhëzimi nr.21 datë 15.10.2021, në kreun II, pika 4 “Njohja dhe njësimi i gradës shkencore Doktor dhe pika 5/1 Njohja dhe njësimi i titujve akademik: Emërtesa Docent, nuk listohet në

hierarkinë e gradave dhe titujve; pra për rrjedhojë nuk parashikohet procedurë njohje dhe njësimi për emërtesën Docent.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr.21, datë 15.10.2021 të MAS, diplomat e sipërcituara nuk përmbushin kriteret për tu njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë.”

Komisioni *AdHoc*, në përfundim, bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar, për arsye se diplomat e z.M. nuk përmbushin kriteret për të njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, bazuar në pikën 7, kreu III, të Udhëzimit nr.21.2021, të ndryshuar, procesverbalin nr.3, datë 26.4.2024; urdhrin nr.179, datë 18.4.2024, të MAS; Urdhrin nr.113, datë 26.3.2024 të MAS; urdhrin nr.183, datë 23.4.2024 të MAS ka vendosur: “Mosnjohjen e diplomës “*Venia Docendi*” dhe titullin akademik “*Profesor i Asociuar*”, lëshuar nga Universiteti i Bernës për z.T. A. M. ”

Z.T.M ka depozituar në MAS ankimin me objekt “*Kundërshtimi i vendimit nr.7, datë 26.4.2024, nr.protokolli 2864. Nxjerrja e një vendimi të ri, duke rregulluar pasojat për palën ankimuese*”. Ky ankim është protokolluar në MAS me nr.3147 datë 15.5.2024.

Ankimi është marrë në shqyrtim në mbledhjen e Komisionit *AdHoc*, të zhvilluar në datën 11.7.2024 dhe në procesverbalin me nr.4443 prot datë 11.7.2024, ky komision është shprehur:

“.....Komisioni rivlerësoi edhe një herë dosjen e zotit M. , e shqyrtuar fillimisht në mbledhjen e Komisionit AdHoc të mbajtur me datë 26.4.2024 dhe për të cilën i është dhënë përgjigje nëpërmjet aktit administrative “Vendim nr.7, datë 26.4.2024”. Kundër këtij vendimi z.M. ka paraqitur ankimin administrativ në datën 14.5.2024, të administruar në MAS me nr. 3147 datë 15.5.2024; Është verifikuar edhe një herë dokumentacioni përkatës i dosjes dhe ankimi administrativ i datës 14.5.2024; Z.M. ka bashkëlidhur tre materialet si vijon:

- *Vendimi nr.112, datë 23.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore Doktor dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë Profesor i Asociuar dhe Profesor”, i ndryshuar, specifikisht, kriteret për marrjen e titullit akademik Profesor i Asociuar.*
- *Email të shkëmbyera në Universitetin e Bernës.*
- *Email me z.D. D Head of Section University, Office of Higher Education, Bern.*
- *Kopje të vendimit nr.7, datë 26.4.2024.*
- *Komisioni vëren se nuk janë paraqitur fakte apo dokumentacion shtesë nga pala ankimuese në funksion të njohjes së titullit akademik. Dokumentet e sipërcituara kanë qenë pjesë e shqyrtimit të dosjes, mbi të cilën është marrë vendimi përkatës. Vlen të theksohet fakti se Komisioni AdHoc ka për detyrë funksionale njohjen dhe njësimin e titujve akademikë dhe jo dhënien e titujve akademik. Dhënia e titullit akademik është tagër e universiteteve.*

Kriteret e vendimit nr.112, datë 23.2.2018, kanë të bëjnë me dhënien e titujve akademikë. Komisioni AdHoc, pas shqyrtimit të ankimit administrative të z.T.M ka vendosur: “Të lërë në fuqi vendimin nr.7, datë 26.4.2024, në emër të z.T. A M. “Mosnjohjen Venia Docendi dhe Profesor i Asociuar”, Universiteti i Bernës, Zvicër.”

Me vendimin nr.1, nr.4444 prot, datë 11.7.2024, Komisioni AdHoc ka lënë në fuqi vendimin nr.7, datë 26.4.2024 “Mosnjohje e diplomës Venia Docendi dhe të titullit akademik Profesor i Asociuar lëshuar nga Universiteti i Bernës, Zvicër në emër të z.T. A. M. .”

Vendimi i Komisionit AdHoc nr.7, datë 26.4.2024, për mosnjohje e diplomës “Venia Docendi” dhe titullit akademik “Profesor i Asociuar” lëshuar nga Universiteti i Bernës, Zvicër në emër të z.T.A. M. , është bazuar në ligjin nr.80/2015, si dhe në kriteret dhe procedurën e përcaktuar në udhëzimin nr.21, datë 15.10.2021, të ndryshuar.

Me urdhrat 113, datë 26.3.2024 dhe nr.183, datë 23.4.2024, të MAS, znj.K. ka ushtruar kompetencat e deleguara nga titullari i MAS në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, përfshirë dhe njohjen dhe njësimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituara jashtë vendit.

Me urdhrin nr.179, datë 18.4.2024 të MAS “Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit” është ngritur komisioni AdHoc për kryerjen e procedurave dhe marrjen e vendimeve mbi njohjen e titujve akademikë të fituara jashtë vendit.

SENJOD, si Sekretariat Teknik në zbatim të Kreut I, pika 6, të udhëzimit nr.21/2021, të ndryshuar, pasi ka marrë informacion nga Universiteti i Bernës në Zvicër, si institucioni i cili i ka lëshuar z.M. “Venia Docendi” dhe titullin “Profesor i Asociuar”, ka përgatitur dhe ka dërguar pranë Komisionit AdHoc raportin teknik të datës 26.4.2024, për aplikimin e z.M. , me qëllim vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesit dhe marrjen e një vendimi lidhur me të.

Bazuar në përgjigjet me email që Universiteti i Bernës Zvicër i ka kthyer SENJOD në QSHA në datën 7.3.2024 dhe dy përgjigjet me email dërguar z.M. në datat 26.2.2024 dhe 28.2.2024 (cituar në raportin teknik të datës 26.4.2026, faqe 2-3) rezulton se z.M. i është akorduar titulli akademik “Profesor i Asociuar”, i kushtëzuar në kohë dhe hapësirë, pra z.M. ka pasur të drejtë t’a përdorë titullin “Profesor i Asociuar”, për sa kohë ishte i punësuar në Universitetin e Bernës dhe vetëm në këtë universitet.

Në udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar, Kreu I, pika 6/c, përcaktohet: “6. Kriteret që duhet të përmbushë diploma/certifikata profesionale dhe grada shkencore për tu njohur dhe njësuar janë: c) certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës”.

Pra, bazuar në këtë përcaktim titulli “Profesor i Asociuar” lëshuar z.M. nga Universiteti i Bernës Zvicër nuk përmbush kriterin e vlefshmërisë. Ndërsa titulli “Docent” sipas ligjit nr.80/2015 nuk listohet në hierarkinë e gradave dhe të titujve dhe për rrjedhojë nuk mund të njehsohet.

Gjithashtu, në udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar, në kreun II, pika 4, përcaktohet “Njohja dhe njësimi i gradës shkencore “Doktor” dhe në pikën 5/1 përcaktohet “Njohja dhe njësimi i titujve akademikë”. Emërtesa “Docent” nuk listohet në hierarkinë e gradave dhe të titujve; pra, për rrjedhojë, nuk parashikohet procedurë dhe njësimi për emërtesën “Docent”.

Vendimi nr.112, datë 23.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i asoiuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar, përcakton kriteret dhe standardet shtetërore për fitimin e titujve akademikë në Republikën e Shqipërisë. Këto kriterë janë të standardizuara dhe të njëjta dhe të detyrueshëm për t’u zbatuar nga institucionet e arsimit të lartë të kategorisë universitet të cilët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 60 të ligjit nr.80/2015 si dhe në VKM nr.112 datë 23.2.2018, të ndryshuar.

Pra, titulli akademik i fituar në një universitet në Republikën e Shqipërisë sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.80/2015 dhe VKM nr.112/2018, ka vlerë ligjore dhe është i transferueshëm në të gjitha institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari akademike në Republikën e Shqipërisë, pasi ky titull është ngushtësisht i lidhur me kualifikimet dhe eksperiencën akademike të individit dhe që gëzohet gjatë gjithë jetës.

Gjithashtu në nenin 92, pika 4, të ligjit nr.80/2015 përcaktohet se titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barazvlefshëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes.

Në kushtet kur titulli akademik “Profesor i Asociuar” lëshuar z.M. nga Universiteti i Bernës, Zvicër, ka qenë i kufizuar në kohë, pra z.M. ka patur të drejtën ta përdorte këtë titull për aq kohë sa ishte i punësuar në Universitetin e Bernës Zvicër, dhe për pasojë ky titull nuk është njohur dhe njësuar pasi nuk plotëson kriterin e vlefshmërisë në vendin e origjinës, pra nuk ka vlefshmëri kombëtare në shtetin zviceran.

Ndërsa për diplomën “*Venia Docendi*”si në ligjin nr.80/2015 dhe në udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar, nuk listohet emërtesa “Docent” dhe për rrjedhojë nuk parashikohet njohje dhe njësime për emërtesën “Docent”.

Vendimi i Komisionit *AdHoc* nr.7, datë 26.4.2024, gjithashtu është në të njëjtën linjë me një vendim të mëparshëm të marrë nga Komisioni *AdHoc*, për një rast të ngjashëm të mosnjohjes së titullit akademik, i cili nuk ka pasur vlerë kombëtare në vendin e origjinës, si në rastin e z.S.H për të cilin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë vendimin nr.243, datë 16.9.2024, për konstatimin e mosdiskriminimit të tij nga MAS.

Nga dokumentacioni i administruar lidhur me aplikimin e z.M. për njohjen e diplomës “*Venia Docendi*” dhe titullit akademik “Profesor i Asociuar”, lëshuar nga Universiteti i Bernës Zvicër, rezulton se Komisioni *AdHoc*, i ngritur me urdhrin e MAS nr.179, datë 18.4.2024, ka zbatuar ligjin nr.80/2015 dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar.

Vendimi nr.7, datë 26.4.2024 i Komisionit *AdHoc* i Njohjes së Titujve Akademik është plotësisht i bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, në raportin teknik të hartuar nga SENJOD ku pasqyrohet korrespondenca, informacionet dhe përgjigjet e marra nga Universiteti i Bernës Zvicër, i cili ka konfirmuar vlefshmërinë e kufizuar në kohë të përdorimit të titullit “*Profesor i Asociuar*” nga z.M. , pra vetëm për kohën e punësimit të tij pranë këtij universiteti (nga data 1.12.2020–30.11.2023). Ndërsa për diplomën me emërtesën “*Docent*” ligji nr.80/2015 dhe udhëzimi nr.21/2021, i ndryshuar, nuk përcaktojnë procedurë njohje dhe njësimi për emërtesën “*Docent*”.

Përfundimisht vendimi nr.7, datë 26.4.2024 i Komisionit *AdHoc* i Njohjes së Titujve Akademik është plotësisht i bazuar në legjislacionin për arsimin e lartë dhe për pasojë, Ministri i Arsimit dhe Sportit, si dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, nuk kanë krijuar situatë diskriminuese për ankuesin për asnjërin prej shkaqeve të pretenduara prej tij.

2. Nëpërmjet *email-it* datë 2 dhe 5 dhjetor 2024, ankuesi depozitoi prapësimet në lidhje përgjigjen e MAS, duke parashtruar ndër të tjera:

1. Konfirmimi i ndërhyrjes së vetë Ministrit të Arsimit dhe Sportit:

- a) Përgjigja konfirmon dyshimin se arsyetimi ligjor për mosnjohjen e titujve është përcaktuar nga vetë Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe stafi i tij. Të gjithë anëtarët profesorë të dy komisioneve të ngritura për shqyrtimin e dosjes sime nuk janë profesionistë të drejtësisë dhe, për pasojë, nuk kanë tagrin juridik për të bërë interpretimin e duhur ligjor. Përkundrazi, ata refuzojnë të shqyrtojnë nëse arritjet akademik me të cilat janë marrë titujt e mi në Universitetin e Bernës plotësojnë kriteret akademike dhe shkencore që kuadri ligjor shqiptar përcakton për marrjen e titujve akademikë, një tagër i tyre.
- b) Urdhri nr.179, datë 12.4.2024, konfirmon se, përbërja e profesorëve në Komisionin e *AdHoc* është përzgjedhur dhe ngritur nga vetë Ministria e Arsimit dhe Sportit, znj.O.M , për të cilën kam paraqitur argumente dhe dokumente shterues për arsyet e motivimit të një qëndrimi diskriminues politik dhe si i arsimuar ndaj meje. Përbërja e këtij komisioni përfshin individë me lidhje të qarta politike me Partinë Socialiste dhe Qeverinë, duke vënë në pikëpyetje pavarësinë dhe objektivitetin e tij:

Znj.N.Ç, e cila ka qenë candidate për deputete nga radhët e Partisë Socialiste dhe njëkohësisht person për të cilin kam shprehur publikisht kritika të vazhdueshme për paaftësi në menaxhimin e pandemisë COVID 19, si anëtare e Komitetit të ngritur nga znj.M. gjatë kohës kur ishte Ministre e Shëndetësisë. Kujtoj se, projeksionet e mia për skenarin më të keq, të paraqitura në fillim të pandemisë në emisionin Opinion në TV Klan dhe të cituara disa herë nga qeveria shqiptare, u realizuan fatkeqësisht, duke çuar në mbi 18 mijë vdekje krejtësisht

të parandalueshme¹¹. Për më tepër, kam ngritur shqetësime për integritetin e saj akademik dhe profesional disa herë.

Z.A.C, për të cilin kam shprehur shqetësime të përsëritura lidhur me dhënien e mbi 500 doktoraturave në Universitetin Evropian, secila me një pagesë prej 9000 euro, pa prodhuar shkencë të standardeve kombëtare. Kam vënë në dukje gjithashtu mungesën e produkteve shkencore në nivel ndërkombëtar nga z.C, çka bie ndesh me kriteret ndërkombëtare për t'u bërë anëtar i një Akademie të Shkencave. Gjithashtu, z.C ka shërbyer si kandidat për këshilltar bashkiak nga radhët e Partisë Socialiste¹².

Një tjetër anëtar i këtij komisioni që ka qenë subjekt i një hetimi nga prokuroria për korrupsion lidhur me fondet publike, siç kam raportuar shqetësimin tim në *emailin* tim drejtuar z.T, datë 27.6.2024.¹³

Këto fakte konfirmojnë edhe një herë se komisioni është ndërtuar mbi baza politike, me anëtarë me integritet akademik dhe profesional të dyshimtë.

2. Qëndrimi fyes dhe diskriminues i Komisionit.

Komisioni, i përbërë nga anëtarë me tituj profesor, në përgjigjen ndaj ankimit tim kundrejt paraqitjes së shtojcës ku argumentohet se kualifikimet e mia shkencore dhe akademike të marrë me titullin “*Docent/Habilitation*” tejkalojnë kriteret shqiptare për marrjen e titullit “*Profesor i Asociuar*”, shkruan: “*Vlen të theksohet fakti se Komisioni AdHoc ka për detyrë funksionale njohjen dhe njehsimin e titujve akademikë dhe jo dhënien e titujve akademikë. Dhënia e titullit akademik është tagër e universiteteve*”.

Ky qëndrim jo vetëm është fyes ndaj profilit tim akademik dhe shkencor, por edhe konfirmon qartazi qëndrimin politik ndaj meje. Sipas kësaj përgjigje, njohja në Shqipëri nuk është çështje aftësish dhe përmbushjeje të kriterëve akademike dhe shkencore në përputhje me ligjin shqiptar për dhënien e titujve akademikë.

Ky qëndrim i komisionit bie në kundërshtim me argumentimin e dhënë në përgjigjen e datës 19.11.2024 nga MAS, e cila mbështet vendimin e marrë duke përdorur kriteret e dhënies së titujve akademikë sipas ligjit. Ndër të tjera shkruhet: “*...ky titull është ngushtësisht i lidhur me kualifikimet dhe eksperiencën akademike të individit*”. Pra, edhe një herë konfirmohet përdorimi dhe interpretimi selektiv i ligjit kundër meje.

¹¹ <https://www.kryeministria.al/newsroom/kryeministri-e-r-ne-kuvend-mbi-situaten-covid-19-dhe-masen-per-javet-ne-vijim/> ; <https://dosja.al/pa-mua-mund-te-kishim-18-mije-vdekje-rama-sqaron-deklaraten-e-keni-nxjerr-nga-konteksti-e-degjove-tek-fevziu> ; <https://www.oranews.tv/newsmobile/763011/>)

¹² <https://tiranapost.al/t.m-s.-gj-me-0-publikime-miraton-komisione-me-shkencetare-anonim> ; <https://www.facebook.com/100057220068779/posts/1264495137275128/> ; <https://www.youtube.com/watch?v=95cKKaUePZQ> ; <https://shqiptarja.com/lajm/perfundon-afati-per-regjistrimin-ne-zgjedhje-ps-bd-dhe-aleatet-regjistrojne-kandidatet>

¹³ <https://shqiptarja.com/lajm/tenderi-640-mije-per-nje-mur-e-nje-dere-hetime-per-rektorin-dhe-dy0zvrektoret-e-universitetit>

3. Moszbatimi i ligjit në rastin tim dhe përdorimi selektiv i tij.

Siç argumentohet edhe në pikën 2, përgjigja e MAS konfirmon interpretimin e ligjit sipas preferencave.

“.....ky titull nuk është njohur dhe njësuar pasi nuk plotëson kriterin e vlefshmërisë në vendin e origjinës, pra nuk ka vlefshmëri kombëtare në shtetin Zvicëran”

MAS, paraqet si argument ligjor për mbështetjen e vendimit, faktin që titulli është i lidhur me vendin e punës dhe universitetin dhe nuk ka vlefshmëri kombëtare. Megjithatë, nuk është e qartë se çfarë nënkupton ministria me “vlefshmëri kombëtare”, pasi një individ që mban titullin profesor ose profesor i asociuar në universitetet Zvicerane, për aq kohë sa është në atë pozicion, ka të drejtë ta përdorë titullin profesor kur prezantohet në të gjitha institucionet në të gjithë territorin e Zvicrës. Njohja e titullit varet nga kriteret specifike që secili universitet në Zvicër aplikon, një standard i cili zbatohet edhe në Bashkimin Evropian, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky informacion duhej të ishte i njohur nga MAS dhe është sqaruar prej meje gjatë shkëmbimeve me QSHA.

Fragment nga *emaili* im dërguar QSHA përpara se të vihej në komunikim me universitetin:

“Gjithashtu, me pyetjet tuaja drejtuar universitetit (njësoj si me doktoraturën) tregoni mungesë serioziteti dhe profesionalizmi. Ndryshe nga Shqipëria që e ka të centralizuar sistemin e dhënies se titujve akademik Prof.Asc dhe Prof., duke ndjekur modele komuniste të pasjes se një regjistri, shtetet perëndimore dhe demokratike e kanë të decentralizuar këtë sistem. Titulli lidhet me vendin e punës (universitetin) dhe nuk mbahet përjetësisht. Gjithashtu, ekuivalentimi i një titulli varet nga shteti, institucioni dhe kriteret që ai ka.”

Nëse shqetësimi i ministrisë do të qëndronte, atëherë lindin pikëpyetje se si i njëjti Komision AdHoc, me vendimin nr.3, datë 26.4.2024, ka njësuar titullin e Prof.A.A nga Universiteti i Tenesit, kur edhe në Amerikë vlefshmëria e titullit është e lidhur me universitetin njësoj si në Zvicër¹⁴, ashtu siç ndodh në të gjithë botën perëndimore. Pra, edhe në këtë rast vihet re dhe konfirmohet qartë diskriminimi.

Rasti i z.A.A konfirmon gjithashtu standardin që duhej aplikuar në rastin tim. Titulli i marrë në Shqipëri i nënshtrohet ligjeve shqiptare në momentin që fillon procedura e njësimit. Ndërkohë unë e kam bërë aplikimin për njësimin e titullit në kohën kur titulli ishte i vlefshëm në Zvicër sikurse konfirmohet nga shkëmbimi me universitetin, dhe kjo ishte brenda afatit të përcaktuar në ligj për njësimin e titullit. Me njohjen e titullit, ky titull mbetet gjithmonë i vlefshëm në Shqipëri, ashtu siç

¹⁴Shih: Universiteti i Tenesit – (<https://facultyhandbook.utk.edu/wp-content/uploads/sites/82/2020/12/Faculty-Handbook-2021-Final-2021-01-01-pdf.>)

konfirmohet nga MAS në përgjigjen e saj. Ky shqetësim dhe arsyetim janë paraqitur në ankesën e datës 14 maj 2024, të cilat janë injoruar dhe ende sot nuk janë hedhur poshtë nga MAS.

Sipas komunikimit me QSHA, ku Komisioneri është informuar, rezulton se e njëjta praktikë e ndjekur në rastin e A.A, është zbatuar edhe për 13 tituj *Profesorë* dhe *Profesorë të Asociuar* nga vende si Britania e Madhe dhe SHBA, të cilat ndjekin një praktikë të ngjashme me atë të Zvicrës, ku titujt lidhen me vendin e punës. Këto raste pasqyrojnë qartë procedurat dhe vendimet diskriminuese që janë marrë ndaj meje

4. Injorimi i fakteve të paraqitura.

- a. Vendimi i Komisionit *AdHoc* dhe përgjigja e MAS, përfshirë urdhrin nr.179, datë 12.2.2024, injorojnë të gjitha faktet që janë paraqitur në ankesën e datës 14 maj 2024. As Komisioni dhe as MAS nuk japin asnjë sqarim mbi argumentin ligjor të paraqitur, i cili demonstroi se vendimet e marra për mosnjohjen e dy titujve të mi janë të paligjshme dhe diskriminuese.
- b. Sikurse kam shprehur shqetësimin në disa *email*e, si dhe sqaruar në detaje në ankesën e datës 14 maj 2024, QSHA ka vonuar procedurat për njohjen e titujve të mi duke dërguar një *email* në një institucion që nuk është Universiteti i Bernës. Edhe pse kam kërkuar hetim administrative, ky veprim është mbrojtur dhe fshehur edhe në përgjigjen e MAS, ku për të gjitha shkëmbimet e QSHA me universitetin janë paraqitur adresat e *email*eve të përdorura, përveç *email*it të datës 16.12.2023. Ky email është dërguar në adresën xxx@rochester-bern.ch, një email që nuk ka asnjë lidhje me Universitetin e Bernës. Injorimi dhe fshehja e këtij fakti në përgjigjen e MAS tregon qartë edhe një herë koordinimin dhe procedurën diskriminuese të ndjekur ndaj meje. Komunikimi me Universitetin e Bernës, sikurse tregohet në të gjitha shkëmbimet e paraqitura në përgjigjen e ministrisë, është vendosur vetëm pas ndërhyrjes time për kontaktin me universitetin pasi kuptova vonesat diskriminuese të MAS.
- c. Këto veprime injoruese dhe diskredituese ndaj meje nga MAS konfirmohen edhe nga kërkesa ime drejtuar z.E.T për marrjen e informacionit mbi Komisionin *AdHoc*, kërkesë për të cilën nuk kam marrë ende asnjë përgjigje deri më sot, pavarësisht detyrimit ligjor.

Veprimet e MAS, si dhe të Komisionit, duke përfshirë injorimin e fakteve dhe zbatimin e njëanshëm të ligjit, tregojnë qartë përpjekje të qëllimshme për të dëmtuar imazhin tim dhe për të më diskriminuar titujt, si dhe karrierën time akademike e profesionale. Këto përfundime mbështeten jo vetëm në argumentet e paraqitura më sipër, por edhe në faktin që MAS ka zgjedhur të heshtë dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje për veprimet e saj të paligjshme lidhur me emërimin e rektorit të Universitetit të Tiranës, siç u evidentua në ankesën time te institucioni juaj e cila ju përçua ministrisë. Për më tepër, pavarësisht se i janë paraqitur ministrisë materialet shitesë mbi plagjiaturat e dokumentuara të disa politikanëve dhe akademikëve, kjo e fundit ka vazhduar të zgjedhë heshtjen. Ky qëndrim përbën një tjetër provë të qartë të njëanshmërisë dhe diskriminimit

të ushtruar ndaj meje nga MAS dhe Qeveria Shqiptare, në lidhje me faktet shqetësuese për degradimin e arsimit në vend.

Për rrjedhojë, kërkoj nga institucioni juaj të vlerësojë vendimin e MAS si një akt diskriminimi politik dhe si i arsimuar dhe të përcaktohet si i tillë në përputhje me normat dhe standardet ligjore. Gjithashtu kërkoj marrjen e masave për të revokuar vendimin e refuzimit të njohjes së titujve dhe për trajtimin e aplikimit të njohjes së titujve dhe njehsimin e tyre sipas ligjit.

Në vlerësimin e procedurës së ndjekur nga MAS (Komisioni i Njohjes së Titujve dhe Sekretariati Teknik i QSHA) në vijim referuar Autoriteti Publik, duket se shkeljet nuk janë thjesht gabime të rastësishme administrative, por shfaqin një sjellje diskriminuese dhe të qëllimshme ndaj ankuesit. Kjo bindje forcohet kur analizojmë të gjithë procesin, i cili ka karakter problematik si në aspektin procedural ashtu edhe në aspektin material.

I. Procedura – Sjellja e Autoritetit Publik para dhe pas vendimit të refuzimit të njehsimit të titujve.

1. Keqpërdorimi i dispozitës së rasteve përjashtimore të udhëzimit nr.21/2021.

Pas paraqitjes së ankimit nga ankuesi, Autoriteti Publik zgjodhi të zbatojë rastin përjashtimor të parashikuar në udhëzimin nr.21/2021 të MARS, duke kërkuar verifikimin e autenticitetit të titujve nga Universiteti i Bernës. Sipas pikës 1.2 të Kreut III, të udhëzimit, kjo procedurë lejohet vetëm në raste të dyshimeve të arsyeshme për falsitet. Në rastin në fjalë, këto dyshime nuk janë argumentuar apo dokumentuar, duke shkelur kështu dispozitat ligjore dhe duke e bërë procesin arbitrar.

Prezumimi i autenticitetit të dokumentacionit është prezumim ligjor, për sa kohë ky dokumentacion është paraqitur me vulë apostile, siç e kërkon rregullatori ligjor. Mbetet detyrim i autoritetit publik të arsyetojë dhe të provojë mbi dyshimet e arsyeshme, për falsitetin e mundshëm të dokumenteve të dorëzuara. Ky moment duhej të ishte pjesë e arsyetimit të refuzimit të njehsimit.

Një sjellje e tillë denigruese, e qëllimshme, dhe duhet të vlerësohet si e tillë, duke pasur parasysh pozicionin tim publik dhe kontributin tim në fushën e arsimit dhe shkencës në nivel ndërkombëtar, në kontekstin kur unë kam shërbyer si ish ministër në MAS, jam investuar publikisht në rregullimin e sistemit arsimor në Shqipëri, jam një person publik i mirënjohur për arritje akademike të cilat janë të njohura dhe ndërkombëtarisht (për shembull tre vitet e fundit jam listuar ndër 1% të shkencëtarëve me më shumë influencë në botë nga Universiteti Stanford dhe Elsevier_ etj.)

2. Adresimi i gabuar i kërkesës.

Autoriteti Publik ka dërguar kërkesën për verifikim në një adresë të gabuar, edhe pse adresa e saktë ishte pjesë e dokumentacionit të paraqitur. Ky gabim, në pamje të parë mund të duket njerëzor, por duke pasur parasysh mungesën e çdo përpjekjeje për korrigjim dhe tejkalimin e afateve ligjore (afati 45 ditë i parashikuar në udhëzimin nr.21/2021), sugjeron një qëllim të caktuar për të vonuar

(sabotuar) procesin. Sipas rrethanave, aplikimi është bërë në datën 11.10.2023, ndërsa raporti i Sekretariatit Teknik, lidhur me këtë aplikim mban datën 26.4.2024. Vonesa është e qëllimshme në çdo aspekt dhe kjo vlerësohet, mjafton të shikohet për shembull koha e gjatë prej dy muaj e gjysmë, në komunikimin nga një *email* te tjetri me Universitetin e Bernës (*email* i dt.16.12.2023 dhe *email* i dt 29.2.2024).

3. Tejkalimi i afateve ligjore në kufijtë ekstrem, me 6 muaj.

Sipas udhëzimit nr.21/2021, procedura administrative duhet të përfundonte brenda 45 ditëve, sipas ligjit të kohës. Me ndryshimet ligjore, sot ky afat është 5 ditë për Universitete të Zvicrës (pika 1 e Kreut III)¹⁵. Autoriteti Publik kaloi këtë afat me 6 muaj pa asnjë njoftim dhe arsye dhe informoi për arsyen e vijimit të procedurës, vetëm pas kërkesës time, duke treguar në neglizhencë dhe mosrespektim të procedurave.

4. Përdorimi i pyetjeve denigruese dhe të papërshtatshme në kalim të kufijve të kompetencave.

Komunikimi i mëtejshëm me Universitetin e Bernës, në dy *email*e konsektiv¹⁶, për pyetje mbi vlefshmërinë, ekuivalencën dhe nivelet akademike të titujve, për të cilat u kërkuar njehsimi janë plotësisht jashtë kuadrit ligjor dhe procedurës standarde.

Në komunikimin me Universitetin e Bernës, Autoriteti Publik, përveç pyetjes lidhur me autenticitetin e titujve, ka bërë pyetje që janë tërësisht jashtë kontekstit dhe në kundërshtim me qëllimin e procesit. Edhe më shumë e pajustificueshme është këmbëngulja e administratës me një *email* të dytë drejtuar Universitetit të Bernës, pasi ky i fundit ishte përgjigjur pjesërisht në *email*in e mëparshëm. Më konkretisht, pyetjet: “*Cila është vlefshmëria e titujve në vendin ku janë lëshuar*” apo “*Në cilin nivel është ekuivalent titulli docent*” tregojnë mungesë profesionalizmi dhe respekti.

Për të kuptuar absurdin e këtyre pyetjeve duhet të shpjegojmë konceptin ligjor të (a) “*nivelit të titullit*”, si vlerësohet ky nivel dhe (b) “*vlefshmërisë së titullit akademik*”, çfarë e bën një titull të vlefshëm.

(a) *Niveli i titullit akademik*. Udhëzimi nr.21/2021, i ndryshuar, parashikon dy lloj procedurash, atë për njehsimin e (1) diplomave/gradave shkencore dhe (2) titujve akademikë. Për kategorinë e parë ekziston një shkallë me nivele, ku renditen nivelet e diplomave/gradave nga niveli 1 në nivelin 8, të përcaktuara sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, miratuar me ligjin nr.10247 datë 4.3.2010, që është në përputhje të plotë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve¹⁷.

¹⁵ Sipas ndryshimeve të udhëzimit nr.21/2021 me udhëzimin nr.18/2024, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Udhezimi-Nr.1-date-19.01.2024-NJohjen-dhe-njesimin-e-diplomave-certifikatavegradave-dhe-titujve-te-leshuara-nga-IAL-te-huaja.pdf>

¹⁶ Dy *email*et e dërguara janë pjesë e praktikës administrative, *email* i dt. 16.12.2023 dhe *email* i dt.29.2.2024.

¹⁷ Korniza Evropiane Kualifikimeve është iniciativë e Bashkimit Evropian për identifikimin e kualifikimeve kombëtare në të gjitha vendet evropiane, të cilat fitohen ose arrihen përmes të gjitha formave të arsimit duke nisur nga

Për kategorinë e dytë nuk ka ndarje në nivele, dhe as një marrëveshje ndërkombëtare, por emërtesa titujsh, që sipas përcaktimeve ligjore janë “*profesor i asociuar*”, “*profesor*”, etj. Ekuivalentimi (njesimi) i titujve akademik është pikërisht detyra funksionale e Komisionit të Njehsimit, që në rastin konkret duhej të vlerësonte arritjet akademike me të cilat janë marrë titujt në Universitetin e Bernës dhe plotësimin e kriterëve akademike dhe shkencore që kuadri ligjor shqiptar përcakton për marrjen e titujve akademikë. Këtë detyrim Komisioni dështoi ta realizojë, ndërsa reduktoi misionin e vet në evidentimin (vlerësimin me sy të lirë) se titulli “*Docent*” nuk gjendet i listuar në ligjin shqiptar.

(b) *Vlefshmëria e titujve*. Vlefshmëria e një titulli varet nga rregullatorët e çdo vendi dhe të çdo universiteti. Ligji Shqiptar nuk e lidh vlefshmërinë e një titulli të kufizuar në kohë dhe në hapësirë, ndërsa është praktikë e mirënjohur e vetë Universiteteve Evropiane dhe të Amerikës së Veriut, që të kufizojnë në kohë vlefshmërinë e një titulli. Ndaj përgjigja e kësaj pyetje duhet të bazohet në praktikën ligjore vendase dhe nuk ka se si të vijë nga një institucion i huaj.

5. Mungesa e transparencës.

Autoriteti Publik nuk ka publikuar dhe refuzoi ti përgjigjej kërkesës sime për informacion lidhur me emrat e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, duke shkelur parimet dhe detyrimet ligjore për transparencën të sanksionuara në Kushtetutë dhe Kodin e Procedurës Administrative, praktikë administrative me standarde dhe e stabilizuar në vend. Emrat janë bërë të njohur vetëm pas ankimit dhe gjatë trajtimin të çështjes nga Zyra e Komisionerit për Diskriminimin.

6. Mungesa e trajtimit efektiv të ankimit.

Ankimi administrative kundër vendimit të komisionit për refuzimin e njehsimit të titujve nuk është trajtuar në mënyrë efektive. Nuk janë trajtuar dhe as nuk u është dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në ankim. Përgjigja ndaj këtij ankimi është një arsyetim i thatë dhe ku është cituar në stilin *copy paste*, arsyetimi i vendimit të refuzimit, objekt ankimi.

Më konkretisht, mungon përgjigja dhe arsyetimi se pse Komisioni i Vlerësimit të Titujve nuk ka bërë përputhshmërinë e kriterëve akademike të titullit të dhënë me kriteret akademike për ekuivalentimin e titullit “*Docent*” sipas sistemit të brendshëm akademik (vlerësim të cilin në mënyrë absurd i është kërkuar ta bëjë Universiteti i Bernës në *email*-et e përshkruar më sipër). Në ankimim prezantohen kriteret për të lehtësuar këtë proces, ku rezulton se titulli “*Docent*” të paktën është ekuivalent me titullin “*Profesor i Asociuar*” sepse kriteret e përmbushura për marrjen e këtij titulli tejkalojnë standardet shtetërore për marrjen e titullit “*Profesor i asociuar*”, sipas

arsimi fillor e deri te arsimi i lartë. Kjo kornizë synon të lidh sistemet kombëtare të kualifikimeve të vendeve të ndryshme në një kornizë të përmbashkët evropiane të referencës. Korniza Evropiane e Kualifikimeve përshkruan kualifikimet që fitohen kur një nxënës ose student përfundon një nivel të caktuar arsimor. Thelbi i kornizës ka të bëjë me 8 (tetë) nivele referimi të cilat përcaktojnë atë që një nxënës ose student di, kupton dhe është në gjendje të bëjë në fund të procesit mësimor – “rezultatet e të nxënit”.

legjislacionit shqiptar, të detajuara në VKM nr.112, datë 23.2.2018 “Për caktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”. Kujtojmë që kjo është detyra e vetme që Komisioni i njehsimit të titujve do duhej të kryente dhe që ka dështuar ta kryej.

Arsyetimi i përgjigjes mbi ankimimin nuk plotëson asnjë standard të arsyetimit të vendimit, e nevojshme për një proces të drejtë ligjor, i cili shtrihet edhe në praktikën administrative, e njohur nga jurisprudence e Gjykatës Kushtetuese.

II. Përmbajtja e vendimit të refuzimit.

Arsyet e refuzimit të njehsimit të titujve përmbledhen në :

- Titulli “*Docent*” nuk mund të njehsohet pasi mungon ekuivalenti i këtij titulli në sistemin e brendshëm;
- Titulli “*Profesor i asociuar*” nuk është i vlefshëm në kohë për Universitetin e Bernës që ka lëshuar titullin.

Të dyja këto arsye janë të pambështetura si nga legjislacioni i brendshëm dhe nga legjislacioni ndërkombëtar, respektivisht, për arsye se:

- Nuk ka asnjë pengesë ligjore për njohjen e titujve që nuk kanë ekuivalent të drejtpërdrejtë në praktikën e brendshme, përkundrazi është detyrim ligjor njohja e titujve të fituar në një universitet të huaj. Detyra e Komisionit është të vlerësojë përputhshmërinë e kriterëve akademike, jo të mohojë njohjen për mungesë të ekuivalencës në emërtesë. Në rastin konkret titulli akademik “*Docent*” i lëshuar nga Universiteti i Bernës është ekuivalent me të paktën titullin akademik “*Profesor i asociuar*” siç është arsyetuar gjerësisht në ankimin administrativ drejtuar Autoritetit Publik.
- *Vlefshmëria në kohë e një titulli nga një universitet është irelevante për procesin e njehsimit, dhe kërkesë jo ligjore, pasi legjislacioni shqiptar për njehsimin e titujve akademikë nuk e kushtëzon njohjen në bazë të kësaj. Titulli “Profesor i asociuar” i dhënë nga Universiteti i Bernës ka vlefshmëri të kufizuar në kohë për këtë Universitet, por vlefshmëria e tij në një universitet tjetër brenda Zvicrës ose jashtë saj, vlerësohet rast pas rasti, nga kriteret e brendshme. Ligji shqiptar njeh vlefshmërinë e titullit për të gjithë jetën.*

Pavarësisht dhe për më tepër, në kohën e aplikimit deri brenda afatit 45 ditor, kur duhej të ishte kryer procedura e njehsimit, titulli akademik ka qenë i vlefshëm.

III. Shkelja e Konventave Ndërkombëtare.

Vendimi i mësipërm bie ndesh me Konventën e Lisbonës, të ratifikuar nga Shqipëria, e cila ndalon diskriminimin dhe kërkon që barra e provës për refuzim t’a mbajë Autoriteti Publik. Për më tepër, Konventa parashikon se një titull i njohur në një vend duhet të konsiderohet si i vlefshëm në të

gjitha vendet nënshkruese, përveç rasteve kur ka dallime thelbësore që duhen provuar nga organi publik¹⁸.

Në përmbledhje të sa më sipër, mund të themi se refuzimi i njësimit të titujve akademikë është diskriminues për arsye se:

- Është rezultat i një praktike administrative të kundraligjshme, arbitrare dhe që ka cenuar procesin e drejtë ligjor;
- Është shprehje e një sjellje denigruese dhe diskriminuese, të ndjekur gjatë gjithë procedurës administrative përpara dhe pas vendimmarrjes;
- Sjellja denigruese vijon edhe gjatë trajtimit të ankimit pranë Komisionerit, shprehur në qëndrimin me shkrim të Autoritetit Publik, me mungesë reflektimi nga ana e tij, pavarësisht shkeljeve flagrante të ligjit, mungesës së seriozitetit, siç u trajtua më sipër.
- Trajtim i pabarabartë në krahasim me raste të tjera të ngjashme (shih vendimin nr.3, datë 26.4.2024, ku i njëjti Komision ka njehsuar titullin e Prof A.A nga Universiteti i Tenesit, kur edhe në Amerikë vlefshmëria e titullit është e lidhur me afat). Praktika të ngjashme me rastin e Prof.A.A, janë bërë edhe për raste të tjera, ku nga viti 2021, sipas komunikimit me QSHA (ku dhe Komisioneri është vënë në dijeni në datën 25 nëntor 2024) janë njehsuar nga Autoriteti Publik 13 tituj akademik Profesor dhe Profesor i Asociuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia, vende të cilat i kanë titujt akademik të lidhur me vendin e punës të ngjashëm me praktikën në Zvicër.
- Është i motivuar nga arsye politike dhe personale për shkak të qëndrimeve publike ndaj Ministrisë dhe anëtarëve të Komisionit.

Në përfundim kërkoj,

- Konstatimin e diskriminimit të Autoritetit Publik Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ndaj T.M .
 - Marrjen e masave për të revokuar vendimin e refuzimit të njohjes së titujve dhe për trajtimin e aplikimit të njohjes së titujve dhe njehsimin e tyre sipas ligjit.
3. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: *“8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të*

¹⁸ Konventa e Njohjes së Kualifikimeve në Arsimin e Lartë në Rajonin e Evropës (Traktati i Nohjes së Lisbonës), e ratifikuar nga Shqipëria datë 6.3.2002, ku ndër të tjera parashikohet se:

- Asnjë diskriminim nuk do të bëhet në këtë drejtim për asnjë arsye si gjinia, raca, ngjyra, paaftësia, gjuha, feja, opinion politik, origjina kombëtare, etnike ose sociale e aplikantit.
- Përgjegjësia për të demonstruar se një aplikim nuk i plotëson kërkesat përkatëse i takon organit që bën vlerësimin.
- Çdo vend do të njohë kualifikimet – qoftë për akses në arsimin e lartë, për periudha studimi apo për diploma të arsimit të lartë – si të ngjashme me kualifikimet përkatëse në sistemin e tij, përveç rasteve kur mund të tregojë se ka dallime thelbësore midis kualifikimeve të tij dhe kualifikimeve për të cilën kërkohet njohja.
- Njohja e një kualifikimi të arsimit të lartë të lëshuar në një vend tjetër do të ketë një ose më shumë nga pasojat e mëposhtme; akses në studime të mëtejshme të arsimit të lartë, përdorimin e një titulli akademik dhe akses në tregun e punës.

interesuar”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri zhvilloi në datën 04.02.2025 një seancë dëgjimore.

Seanca dëgjimore e datës 04.02.2025 u zhvillua me pjesëmarrjen e ankuesit z. T.M dhe përfaqësueses së tij ligjore Av. I.De, me Nr. 1969 Liçence dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, përfaqësuar me autorizim nga znj. I. N.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (*vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁹. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme²⁰. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm””²¹

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të LMD, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo

¹⁹ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

²⁰ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

²¹ Shih: *Biao kundër Danimarkës*, *Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016*, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010*, prg. 61.

trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkaku të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se diskriminimi ka ndodhur, duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- Ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin;
- Në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- arsyeja për këtë trajtim është një ose më shumë nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesi, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në lidhje njohjen e dy titujve, Diplomë *Venia Docendi/Privatdozent*²², lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër.

- *Faktet dhe rrethanat.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi T.M ka aplikuar për njohjen e dy titujve të cilat i ka fituar jashtë vendit dhe konkretisht Diplomë *Venia Docendi/Privatdozent*, lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër. Ankuesi ka aplikuar në portalin *e-albania* dhe nëpërmjet shërbimit postar ka depozituar dosjen përkatëse pranë QSHA, e cila rezulton të jetë protokolluar pranë këtij institucioni me nr.4321 prot., datë 11.10.2023.

Me urdhrin nr.179, datë 18.4.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “*Për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e titujve akademik të fituar jashtë vendit*”, është ngritur Komisioni *AdHoc*, i cili sipas pikës 3 të këtij urdhri duhet të shqyrtonte dokumentacionin e aplikimeve për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, si dhe të nënshkruante procesverbalet përkatëse në përfundim të procedurave të njohjes. Sipas pikës 2, të

²² Referuar përkthimit zyrtar të dokumentit “Pedagog Privat”

këtij urdhri, Komisioni *AdHoc*, drejtohet nga Ministri dhe ka në përbërje anëtarët: Prof.Asoc. N. Ç-anëtar; Prof.Dr. A. C-anëtar; Prof.Dr. R.K-anëtar; Prof.Dr. Dh.B -anëtar;

Me urdhrin nr.113 datë 26.3.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “*Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.A.K*”, kompetencat e titullarit të MAS, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor i janë deleguar Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.K. . Sipas urdhrit nr.183, datë 23.4.2024, të MAS “*Për një shtesë në urdhrin nr.113, datë 26.3.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.A.K*”, znj.A.K, si Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, në ushtrim të kompetencave të deleguara nga titullari i MAS, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është ngarkuar të kryejë dhe detyrën: “*sh) Ndjek dhe nënshkruan njohjen dhe njësimin e titujve akademikë dhe gradave shkencore të fituara jashtë vendit duke përfshirë kryesimin dhe ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG) dhe komisioneve ad-hoc për njohjen e titujve akademikë për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”.*”

Komisioni *AdHoc* i Njohjes së Titujve Akademikë, i ngritur me urdhrin nr.179, datë 18.4.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, në mbledhjen e zhvilluar në datën 26.4.2024, ka marrë në shqyrtim aplikimin dhe dokumentacionin e depozituar nga z.T.M, përfshirë dokumentacionin dhe dosjet e depozituara nga 6 (gjashtë) aplikantë të tjerë për njohjen e titujve akademikë.

Referuar procesverbalit nr.3, nr.2587 prot, datë 26.4.2024, rezulton se, Komisioni *AdHoc* pas shqyrtimit të dosjeve përfshirë dhe dosjen e aplikimit të z.M., në pikën II/1 ka vendosur: “*Të mos njohë Titullin Akademik si më poshtë: T. A M., Profesor i Asociuar, Universiteti i Bernës, Zvicër.*”

Me vendimin nr. 7, datë 26.04.2024 (nr.2864 prot., datë 26.04.2024), Komisioni *AdHoc* i Njohjes së Titujve Akademikë, i ngritur sipas Urdhrit nr. 179, datë 18.04.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, ka vendosur: “*Mosnjohjen e diplomës “Venia Docendi” dhe titullit akademik “Profesor i Asociuar”, lëshuar nga Universiteti i Bernës për z. T. A. M. .*”.

Ankuesi e ka kundërshtuar në rrugë administrative vendimin nr.7, datë 26.04.2024, të Komisionit *AdHoc* të Njohjes së Titujve Akademikë, të ngritur sipas Urdhrit nr. 179, datë 18.04.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, duke paraqitur ankim administrativ pranë MAS, ankim i cili është administruar me nr.3147 prot., datë 15.05.2024.

Për marrjen në shqyrtim të ankimit të paraqitur nga ankuesi, me urdhrin nr.355, datë 10.07.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit²³ është ngritur Komisioni *AdHoc* me pedagogë të kategorisë Profesor, ekspertë në fushën e shkencave mjekësore/shëndetësore, për marrjen në shqyrtim të ankimit dhe aplikimit të njohjes së titullit akademik të fituar jashtë vendit nga z.T.M. . Sipas pikës

²³ Përfaqësuar me urdhër dhe me delegim nga Zëvendësministër znj. A.K, sipas urdhrit nr.113, datë 26.03.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “*Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.A.K*”, ndryshuar me urdhrin nr. 183, datë 23.04.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

2, të këtij urdhri, Komisioni *AdHoc* kryesohet nga znj. A.K , zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit dhe ka në përbërje anëtarët: Znj. N. Ç-anëtar; Z.J. B-anëtar; Znj.S. B-anëtar; Znj. E. H-anëtar;

Referuar procesverbalit nr.5, (nr.4443 prot, datë 11.07.2024), rezulton se, Komisioni *AdHoc* pasi mori në shqyrtim ankimin e paraqitur dhe rivlerësoi dosjen e z.M. , në pikën II/1, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr.7, datë 26.04.2024, “Mosnjohje e diplomës Venia Docendi dhe të titullit akademik Profesor i Asociuar, lëshuar nga Universiteti i Bernës për z. T. A. M. .”*

Me vendimin nr.1, datë 11.07.2024 (nr.4444 prot., datë 11.07.2024), Komisioni *AdHoc* i Njohjes së Titujve Akademikë, vendosi: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr.7, datë 26.04.2024, “Mosnjohje e diplomës Venia Docendi dhe të titullit akademik Profesor i Asociuar, lëshuar nga Universiteti i Bernës për z. T. A. M. .”*

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga titullari i këtij institucioni znj. O.M , Ministre e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore, duke mos i njohur dy titujt akademikë të fituar jashtë vendit, *Venia Docendi/Privatdozent*²⁴, lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin *“Profesor i Asociuar”* lëshuar më 1.12.2020, dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër.

- *Legjislacioni i zbatueshëm.*

Me ligjin nr. 8834, datë 22.11.2001, është ratifikuar Konventa *“Për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Europë”* (Konventa e Lisbonës, e vitit 1997). Ndër të Tjera në Konventën e Lisbonës, parashikohet:

Seksioni III. Parimet bazë për vlerësimin e kualifikimeve

Neni III.1

1. Titullarët e kualifikimeve të dhëna nga njëra nga Palët kanë një hyrje të përshtatshme në vlerësimin e këtyre kualifikimeve, me anë të një kërkesë të tyre adresuar një organizmi kompetent.

2. Në këtë pikë nuk bëhet asnjë dallim i bazuar në seksin, racën, ngjyrën e lëkurës, handikabin, gjuhën, opinione politike ose çdo opinion tjetër, origjinën kombëtare, etnike ose sociale, përkatësinë në një minoritet kombëtar, pasurinë, lindjen ose çdo rrethanë tjetër të kërkuarve, ose çdo rrethanë tjetër që nuk ka lidhje me vlerën e kualifikimit për të cilën është kërkuar njohja. Për të siguruar këtë të drejtë, çdo Palë angazhohet të ndërmarrë dispozitat e nevojshme për të vlerësuar çdo kërkesë njohjeje të kualifikimit, duke marrë parasysh vetëm njohjet dhe aftësitë e fituara.

²⁴ Referuar përkthimit zyrtar të dokumentit *“Pedagog Privat”*

Neni III.3

- 1. Vendimet e njohjes merren mbi bazën e informacioneve të përshtatshme në lidhje me kualifikimet për të cilat është kërkuar njohja.*
- 2. Përgjegjësia e dhënies së informacioneve të nevojshme bie, në radhë të parë, mbi kërkuesin, i cili duhet t'i japë në mirëbesim.*
- 3. Megjithë përgjegjësinë e kërkuesit, me kërkesën e këtij të fundit, institucionet që kanë dhënë kualifikimet në fjalë kanë për detyrë t'i japin informacionet e përshtatshme në limitet kohore të arsyeshme. E njëjta detyrë bie edhe mbi institucionet ose organet kompetente të vendit ku është kërkuar njohja.*
- 4. Palët u japin udhëzime të gjitha institucioneve të arsimit, sipas sistemeve të tyre arsimore, të përcjellin çdo kërkesë të arsyeshme informacione të bërë me qëllim vlerësimin e kualifikimeve të bëra në këto institucione ose, sipas rastit, t'i inkurajojnë këto institucione për ta bërë këtë gjë.*
- 5. U takon organizmave që ndërmarrin vlerësimin të vërtetojnë se një kërkesë nuk i plotëson kushtet e nevojshme.*

Neni III.5

Vendimet e njohjes merren me një afat të arsyeshëm, të përcaktuar paraprakisht nga autoritetet kompetente në çështjet e njohjes, duke filluar nga momenti kur janë dhënë të gjitha informacionet e duhura për ekzaminimin e kërkesës. Në rast të një vendimi negativ, jepen arsyet e refuzimit dhe kërkuesi informohet mbi masat që mund të marrë për të arritur njohjen në një moment të dytë. Në rast të një vendimi negativ ose të mungesës së vendimit, kërkuesi duhet të ketë mundësinë të apelojë kundrejt këtij vendimi në një afat kohor të arsyeshëm.

Seksioni VI. Njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë

Neni VI.1

Në rastet kur një vendim njohjeje bazohet mbi njohjet dhe dijet e vërtetuara nga një kualifikim i arsimit të lartë, secila Palë njeh kualifikimet e arsimit të lartë të dhëna nga një Palë tjetër, me përjashtim të rasteve kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet kualifikimit të cilit i kërkohet njohja dhe kualifikimit korrespondent në Palën në të cilën kërkohet njohja.

Neni VI.5

Duke qenë se flitet për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë të dhëna nga një institucion i arsimit të lartë i vendosur në territorin e vet, secila Palë mund t'ia nënshtrojë këtë njohje kushteve specifike të legjislacionit kombëtar ose marrëveshjeve specifike të nënshkruara me Palën prej nga e cila varet ky institucion.

Njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, rregullohet nga ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.80/2015).

Në nenin 92 “Njohja e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë”, të ligjit nr.80/2015, përcaktohet se:

*“1. **Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen** përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.*

*2. **Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet** në bazë të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.*

3. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësia përgjegjëse e njësimit të diplomave.

*4. **Titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes.***

5. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare, në Republikën e Shqipërisë, të titujve akademikë të lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin.

*6. **Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim.** Ministria përgjegjëse për arsimin mund të përcaktojë dhe vlefshmërinë e diplomës së njësuar, sipas fushës së punësimit.*

7. Ministria përgjegjëse për arsimin mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njësuar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë.”

Në ligjin nr.80/2015, në nenet 60 dhe 61, përcaktohet:

“Neni 60

Titujt akademikë

1. Titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” jepen nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit “universitet”, të cilët:

a) ushtrojnë veprimtari akademike dhe kërkimore shkencore, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se dhjetë vjet;

b) janë institucione të akredituara;

c) kanë të punësuar si personel akademik jo më pak se tetëmbëdhjetë anëtarë të personelit akademik që mbajnë titullin “Profesor”, me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar. Në çdo rast, universiteti duhet të ketë të paktën pesë pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin profesor në çdo fakultet;

ç) ofrojnë studimet e doktoratës apo specializime afatgjata;

d) përmbushin kritere të tjera shtesë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Lista e institucioneve të arsimit të lartë, që përmbushin kriteret për dhënien e titujve akademikë, publikohet zyrtarisht çdo vit akademik nga ministria përgjegjëse.

3. Standardet shtetërore për fitimin e titujve “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e arteve, sporteve, rendit dhe mbrojtjes, mund të japin tituj të tjerë, veç atyre të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ekuivalent me to, sipas parashikimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Neni 61

Fitimi i titujve akademikë

1. Për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore “Doktor”, prej së paku pesë vitesh, është personel akademik i kategorisë “Lektor” dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit. Për fitimin e titullit “Profesor” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku pesë vjetësh titullin “Profesor i asociuar”, si dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit.

2. Personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë, të cilat nuk përmbushin kriteret për dhënien e titujve akademikë, si dhe personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet për fitimin e titujve, paraqesin kërkesën pranë një institucioni, i cili përmbush kriteret për dhënien e titujve.

3. Kandidati për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” ose “Profesor” paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet senatit akademik, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. Senati i kalon dosjen Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përmbushjen e standardeve. Titulli regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe firmoset nga rektori.

4. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se dy vjet.

5. Personelit akademik, që mban titullin “Profesor”, pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli “Profesor emeritus”.”

Kriteret dhe procedurat për njohjen e titujve akademikë të fituara jashtë vendit, përcaktohen në bazë të udhëzimi nr.21, datë 15.10.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”²⁵, i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 92, pika 6, të ligjit nr.85/2015.

Në udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar, përcaktohet:

Kreu I “Dispozita të Përgjithshme”

2. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të gradës shkencore "Doktor", të fituar në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për Arsimin e Lartë, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe stardardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Ministria përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet Komisioneve përkatëse. Sekretariati teknik për këtë shërbim ndodhet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

6. Kriteret që duhet të përmbushë diploma/certifikata profesionale dhe grada shkencore për t’u njohur dhe njësuar janë:

- a) të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura dhe/ ose të akredituara të arsimit të lartë në vendin e origjinës;
- b) programi i studimit në përfundim të të cilit lëshohet diploma/certifikata profesionale apo diploma të jetë i njohur/akredituar në datën e lëshimit të saj;
- c) certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës;
- ç) certifikata apo diploma të jetë autentike.

7. Informacioni paraprak mbi institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me standardet përkatëse të vendit të origjinës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Rrjetit Evropian të Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC). Në lidhje me dhënien e informacionit për të interesuarit për sistemin dhe institucionet e arsimit të lartë, si dhe kualifikimet e lëshuara prej tyre në Republikën e Shqipërisë institucion përgjegjës është QSHA-ja.

Kreu II “Procedurat e Aplikimit dhe Dokumentacioni”

“5. Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Shqipërisë të titujve akademikë të fituar jashtë vendit, bazohet në kriteret dhe standardet shtetërore të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, për fitimin e titujve akademikë.”

5.1 Aplikimi për njohjen e titujve akademikë kryhet online sipas procedurës së mëposhtme:

²⁵ Ndryshuar me udhëzimin nr.18, datë 08.07.2022 dhe nr.1, datë 19.01.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

- a) formulari i aplikimit plotësohet online në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1;
- b) aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:
- i. dokumentin e fitimit të titullit akademik, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njëzuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;
 - “ii. Kopjen e dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore “Doktor”, e noterizuar dhe shoqëruar me vërtetimin e njohjes së gradës shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë, nëse studimet pararendëse janë ndjekur jashtë vendit.”;
 - iii. vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në bazën e të dhënave përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor të vendit ku është fituar titulli akademik (nëse ky regjistrim është parashikuar nga legjislacioni përkatës i huaj);
 - iv. fotokopjen e kartës së identitetit apo pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);
 - v. mandatpagesën ose konfirmimin e pagesës online, sipas shtojcës nr. 2;
 - vi. deklaratën/skedën e nënshkruar në të cilin të jepet informacion për eksperiencën akademike në mësimdhënie; aktivitetin shkencor – lista e artikujve/botimeve shkencore, pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të shoqëruar me titujt e materialeve të paraqitura; si dhe botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare. Informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacionin provues përkatës.

Kreu III “Procedurat e Njohjes dhe Të Njësimit”

2. QSHA në zbatim të procedurës së verifikimit:

- a. kërkon informacion nëse programi i studimit i përfunduar nga aplikanti në një institucion të huaj të arsimit të lartë apo institucion tjetër i autorizuar është i hapur/licencuar si program studimi online;
- b. kërkon çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës;
- c. i kërkon përmes postës elektronike IAL-së përkatëse konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë dhe në rast mos përgjigjeje, konfirmimi kërkohet me shkresë zyrtare (dërguar me postë zyrtare). Në rast se pas 1 viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA. Aplikanti njoftohet për vendimin e komisionit mbi arkivimin e dokumentacionit. Gjithashtu, konfirmimi kërkohet edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse sipas rastit;
- ç. QSHA i referohet listës zyrtare të institucioneve të njohura/licencuara/ akredituara në vendin e origjinës të publikuar në faqet përkatëse zyrtare të rrjetit ENIC-NARIC dhe sipas rastit kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC-NARIC) dhe institucioneve përgjegjëse të shteteve të tjera mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të

njësimit të diplomës. QSHA shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Republikën e Shqipërisë;

- d. materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera online, dokumentacioni i printuar firmoset nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.*

7. Për njohjen e titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin komisione AdHoc, për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”. Komisionet AdHoc për njohjen e titujve akademikë kryesohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe përbëhen nga kryetari dhe katër anëtar.

1.1 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisioneve AdHoc.

1.2 Kërkesa për ngritjen e komisionit AdHoc kryhet nga Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA, menjëherë pas depozitimit të aplikimit për njohjen e titullit akademik të fituar jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

1.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit Ad Hoc nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, vërtetimi lëshohet nëpërmjet sistemit online me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarit, sipas shtojcës nr.5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

1.4 Procedura e njohjes së titullit akademik të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

1.5 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3 të kreut III të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.”

Standardet shtetërore për fitimin e titujve në Republikën e Shqipërisë, përcaktohen në vendimin nr.112, datë 23.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i asosiuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar, i cili është një akt nënligjor që ka dalë në bazë dhe për zbatim të neneve 60 (titujt akademik), pika 3 , e 79 (studimet e doktoratës), pika 7, të ligjit nr. 80/2015.

Referuar kësaj VKM-je, kriteret për fitimin e titujve akademikë janë të standardizuara dhe të njëjta, dhe të detyrueshme për t’u zbatuar nga institucionet e arsimit të lartë të kategorisë universitet të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 60 të ligjit nr.80/2015, si dhe në VKM nr.112 datë 23.2.2018, të ndryshuar.

Bazuar në përcaktimet e mësipërme të ligjit nr.80/2015 dhe VKM nr.112/2018, të ndryshuar, titulli akademik i fituar në një universitet në Republikën e Shqipërisë ka vlerë ligjore dhe është i transferueshëm në të gjitha institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari akademike në Republikën e Shqipërisë dhe gëzohet gjatë gjithë jetës.

- *Analiza e fakteve dhe rrethanave.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se ankuesi ka aplikuar *online*, më datë 16.10.2023 për njohjen e dy titujve akademikë të fituar jashtë vendit, konkretisht Diplomë *Venia Docendi/Privatdozent*²⁶, lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër, aplikime të cilat mbajnë numrat e gjurmueshmërisë: MASR-2023-3764803-DF dhe MASR-2023-7287896-US.

Sektori i Njohjes së Diplomave (SENJOD) në QSHA, i cili shërben si Sekretariat Teknik i Komisioneve *AdHoc*, ka për detyrë të administrojë, vlerësojë dhe paraqesë në komision dokumentacionin, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.21, datë 15.10.2021, i ndryshuar.

SENJOD në QSHA, lidhur me aplikimet e z.M. për të njohur dhe njësuar diplomën *Venia Docendi/Privatdozent*, lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, nga Universiteti i Bernës, Zvicër, i është drejtuar këtij universiteti në datën 16.12.2023, me email²⁷ në adresën: xxx@rochester-bern.ch, duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

- *A është secili nga titujt bashkëngjitur autentik?*
- *Me cilin nivel/shkallë ekuivalentohet Venia Docendi/Privatdozent?*
- *A kanë këta titujt vlefshmëri kombëtare në Zvicër?*
- *A janë të regjistruar në regjistrin kombëtar të titujve akademik në Zvicër?*

Në bazë të komunikimeve me email të administruara, rezulton se, emaili xxx@rochester-bern.ch, nuk i përket Universitetit të Bernës, Zvicër.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, nga emaili xxxx@rochester-bern.ch, i është kthyer përgjigje SENJOD, në QSHA, më datë 26.02.2024, duke informuar se, në lidhje me këtë kërkesë duhet të kontaktonin në adresën: xxxxxxx@unibe.ch. Në vijim, SENJOD, në QSHA, e ka drejtuar të njëjtën kërkesë në këtë adresë.

Rezulton se, ankuesi ka komunikuar me IAL, në adresat e emailit: xxxxxxx@unibe.ch, xxxxxxx@unibe.ch, xxxxxxx@unibe.ch, xxxxxx@unibe.ch, xxxxxxx@be.ch.

²⁶ Referuar përkthimit zyrtar të dokumentit “Pedagog Privat”

²⁷ Email në anglisht i datës 16.12.2023:

The information should include:

- *Is each of the degree attached authentic;*
- *To what level/degrees is the Venia Docendi/Privatdozent equivalent to?*
- *Does these title have nationwide validity in Switzerland?*
- *Are they registered in the national register for academic titles in the Switzerland?*

Nëpërmjet emailit të datës 29.02.2024, dërguar nga adresa elektronike xxxxxxx@be.ch, z. D. S D, konfirmon se diplomat e ankuesit janë autentike dhe nuk është e nevojshme për hapa të mëtejshëm për njohjen e tyre.

QSHA, në adresën elektronike xxxxxxx@be.ch, të z.D.S D, në datën 29.2.2024, ka dërguar një email²⁸, nëpërmjet të cilit pasi shpreh falënderimin për përgjigjen e dërguar për pyetjen e parë kërkon më shumë informacion për verifikimin e titujve të ankuesit, duke parashtruar pyetjet që nuk kishin marrë përgjigje:

- *Me cilin nivel/shkallë ekuivalentohet Venia Docendi/Privatdozent?*
- *Tituj (Venia Docendi/Privatdozent and Associated Professor) a kanë vlefshmëri kombëtare në Zvicër? Me fjalë të tjera a mund të përdoren këta tituj në universitete të tjera në Zvicër ose jashtë vendit?, apo janë të kufizuar për përdorim vetëm në Universitetin e Bernës.*

Në kthim-përgjigjen datë 07.03.2024, drejtuar QSHA, nga adresa, xxxxxxx@be.ch, citohet: “*Venia Docendi/Privatdozenti*” është niveli i kualifikimit pas nivelit Ph.D/doktoraturë. Është niveli më i lartë i kualifikimit të një karriere universitare. Parakusht është shkrimi i një teze habilitimi, e cila është një veçori e veçantë e universiteteve gjermane dhe universiteteve gjermanishtfolëse në Zvicër. Pas përfundimit me sukses të këtij niveli, mund të përdoret titulli “Privatdozent (PD) si dhe personi mund të aplikojë për titullin profesor në universitet. Dy tituj “Privatdozent dhe Profesor i Asocuar janë vendosur si më poshtë:

- *Titulli “Privatdozent” mund të vazhdojë të mbahet nga mbajtësi pas largimit nga universiteti.*
- *Megjithatë, titulli/funksioni “Profesor i Asocuar” është e lidhur me institucionin dhe nuk mund të përdoret më, pas largimit nga universiteti.”*

Autoritetet e universitetit i kanë kthyer përgjigje z.M. me emailin në datat 28.2.2024 dhe 26.2.2024, në të cilat thuhet:

Emaili i datës 28.2.2024, dërguar nga adresa xxxxxxx@unibe.ch: “*Jemi të lumtur të konfirmojmë se ju keni të drejtë të mbani titullin profesor të asociuar në Universitetin e Bernës që nga momenti i dhënies së titullit (1 dhjetor 2020) deri më 30 nëntor 2023)*”

²⁸ Email në anglisht i datës 29.02.2024:

Dear D D

Thanks for your response regarding the title verification of Mr. M.

You have already answered to the first question. For the sake of the recognition procedure I still need to collect more information regarding this titles. So the pending questions are as follows:

The information should include:

- To what level/degrees is the Venia Docendi/Privatdozent equivalent to?
- Do these titles (Venia Docendi/Privatdozent & Associated Professor) have nationwide validity in Switzerland? In other word can these titles be used by other universities in Switzerland or abroad? Or are they bound only to the University of Bern?

Email i datës 28.2.2024, dërguar nga adresa xxxxxxxxx@unibe.ch: “Ne i referohemi emaileve tuaja të ndryshme drejtuar Prof.S, Prof.Z dhe Dr.S. Universiteti flet me një zë dhe korrespondenca kryhet në mënyrë uniforme nëpërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm. Ne konfirmojmë dhënien e vedia docenti dhe të drejtën shoqëruese për të mbajtur titullin e pedagogut privat. Për pozitën e profesorit shoqërues²⁹ vlen sa vijon: E drejta për të përdorur këtë titull ekziston vetëm gjatë punësimit në Universitetin e Bernës. Ky nuk është rasti. Prandaj ju keni humbur të drejtën për të mbajtur këtë titull.”

Në vijim të procedurës së njohjes së titujve akademikë, rezulton se me urdhrin nr.179, datë 18.04.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit është ngritur Komisioni *AdHoc* për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, përbërja e të cilit referohet më sipër në vendim.

Në datën 26.04.2024, SENJOD, në QSHA, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit *AdHoc* ka përgatitur raportin teknik në lidhje me aplikimin e z.T.M, në të cilin janë pasqyruar dokumentet e depozituara, si dhe materialet e printuara për të gjitha verifikimet e kryera nga SENJOD. Referuar raportit teknik të datës 26.04.2024, rezulton se Sekretariati Teknik, pra SENJOD, në QSHA, i ka parashtruar Komisionit *AdHoc*, konkluzionet e arritura në përfundim të shqyrtimit dhe verifikimit të aplikimit, duke parashtruar se SENJOD vëren se diplomat e ankuesit nuk i përmbushin kriteret për tu njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë.

Procedura e njohjes së dy titujve, ka përfunduar nëpërmjet vendimmarrjes së Komisionit *AdHoc*, me nr.7, datë 26.04.2024, i cili ka vendosur mosnjohjen e të dy titujve të fituar jashtë vendit nga ana e ankuesit, konkretisht Diplomë *Venia Docendi/Privatdozent*³⁰, lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, dhënë Universiteti i Bernës, Zvicër. Referuar këtij vendimi, konstatohet se, arsyet e parashtruara nga Komisioni *AdHoc* për mosnjohjen e dy titujve akademik të fituar jashtë vendit nga ankuesi janë, respektivisht:

- Titulli akademik *Profesor i Asociuar*, akorduar ankuesit më datë 01.12.2020, nga Universiteti i Bernës, Zvicër, është i kushtëzuar në kohë dhe në hapësirë, pra ankuesi ka patur të drejtë ta përdorë këtë titull për aq kohë sa ishte i punësuar në Universitetin e Bernës dhe vetëm në këtë universitet. Nuk përmbushet kriteri i vlefshëmrisë sipas pikës 6/c, kreu I, të udhëzimit të MAS nr.21, datë 15.10.2021, të ndryshuar.
- Titulli *Docent/Diploma Venia Docenti/Privatdozent*, akorduar ankuesit më datë 30.06.2020 nga Universiteti i Bernës, Zvicër, nuk listohet në hierarkinë e gradave dhe titujve, sipas ligjit nr.80/2015 dhe udhëzimit të MAS nr.21, datë 15.10.2021, të ndryshuar.

Rezulton se, ankuesi ka aplikuar *online* (sipas kërkesave të udhëzimit nr.21, datë 15.10.2021, të ndryshuar) për procedurën e njohjes së titujve akademikë të fituar jashtë vendit, më datë 16.10.2023 (datë kur rezulton të jetë shfaqur në sistem aplikimi, ndërsa nëpërmjet shërbimit postar

²⁹ Profesor i Asociuar.

³⁰ Referuar përkthimit zyrtar të dokumentit “Pedagog Privat”

ka depozituar dosjen përkatëse pranë QSHA, e cila rezulton të jetë protokolluar pranë këtij institucioni me nr.4321 prot., datë 11.10.2023) dhe dosja e aplikimit është plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, më datë 07.03.2024 (*emaili* nga z.D. S. D, përfaqësues i IAL, që ka lëshuar titujt), ndërsa procedura e njohjes ka përfunduar me datë 26.04.2024.

Referuar përcaktimeve që bëhen në pikën 7.4, të kreut III, të udhëzimit nr.21, datë 15.10.2021, të ndryshuar, rezulton se, afati 45 ditor për përfundimin e procedurës fillon të përlllogaritet nga momenti që dojsa e aplikimit është plotësuar me të gjitha kërkesat e parashikuara nga udhëzimi 21, datë 15.10.2021, i ndryshuar, që në rastin konkret data e plotësimit, është data 07.03.2024. Në kushtet kur dosja e aplikimit është plotësuar më datë 07.03.2024, atëherë procedura e njohjes duhet të kishte përfunduar më datë 21.04.2024. Pra, rezulton se procedura e njohjes është në tejkalim të afatit të parashikuar për përfundimin e saj me 5 ditë dhe jo sikurse pretendohet nga ankuesi për një tejzgjatje prej 6 muaj.

Në pikën 25 të formularit të aplikimit kërkohet që aplikanti të japë informacione në lidhje me kontaktet zyrtare të universitetit/institucionit që ka lëshuar titullin akademik për të cilin është aplikuar për procedurën e njohjes (adresën, qytetin, shtetin, kodin postar, nr.telefoni dhe adresë emaili). Referuar formularëve të aplikimit për secilin nga titujt akademik për të cilët është aplikuar nga ana e ankuesit, konstatohet se nuk janë dhënë nga ana e këtij të fundit informacione për IAL që ka lëshuar titujt (është plotësuar vetëm qyteti, shteti, kodi postar dhe nuk është vendosur adresa dhe nr.telefonit) dhe në vend të *email-it* të IAL që ka lëshuar titujt është vendosur adresa e vetë ankuesit.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, nuk konstatohet se, dërgimi i kërkesës për verifikimin e titujve akademikë nga ana e SENJOD, në QSHA në *emaili-in* xxxxx@rochester-bern.ch, adresë e cila rezultoi se nuk i përket Universitetit të Bernës, Zvicër, në kushtet kur ankuesi nuk ka vendosur në formularin e aplikimit kontakte të IAL që ka lëshuar titujt, të ketë qenë i qëllimshëm. SENJOD në QSHA, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit *AdHoc*, ka reaguar në mënyrë të menjëhershme, brenda ditës, sapo është njoftuar nëpërmjet *emailit* xxxx@rochester-bern.ch, se ky i fundit nuk ishte një kontakt i IAL, duke iu drejtuar këtij të fundit në *emailin* e vendosur në dispozicion.

Në pikën 2, të kreut III, të udhëzimit nr.21, datë 15.10.2021, përcaktohet procedura e verifikimit që ndiqet nga ana e QSHA, në kuadër të njohjes dhe njësimit. Kjo procedurë rezulton që të jetë ndjekur nga SENJOD në QSHA, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit *AdHoc* edhe në rastin e ankuesit.

Konventa e Lisbonës, e vitit 1997, e cila është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8834, datë 22.11.2001, parashikon se, vendimet e njohjes merren mbi bazën e informacioneve të përshtatshme në lidhje me kualifikimet për të cilat është kërkuar njohja. Konventa thekson se, përgjegjësia e dhënies së informacioneve të nevojshme bie, në radhë të parë, mbi kërkuesin, i cili duhet t'i japë në mirëbesim, dhe se, megjithë përgjegjësinë e kërkuesit, me kërkesën e këtij të fundit,

institucionet që kanë dhënë kualifikimet në fjalë kanë për detyrë t'i japin informacionet e përshtatshme në limitet kohore të arsyeshme. E njëjta detyrë bie edhe mbi institucionet ose organet kompetente të vendit ku është kërkuar njohja (*neni III.3*). Në këtë mënyrë procedura verifikuese e reaziluar, vjen në përputhje me parashikimet e Konventës së Lisbonës.

Në kushtet kur ankuesi nuk i ka ofruar organeve përgjegjëse për procesin e njohjes kontaktet e IAL, të kërkuara shprehimisht edhe në formularin e aplikimit dhe në kushtet kur përgjigja nga emaili xxxxxx@rochester-bern.ch, i ka ardhur SENJOD në QSHA rreth dy muaj nga dërgimi i emailit tek ky i fundit, si dhe adresimi i menjërhershëm i komunikimit për verifikimin e titujve në adresën e të IAL nga ana e SENJOD në QSHA, nuk mbështesin pretendimin e ankuesit se procesi i njohjes është zvarritur dhe tejzgjatur në mënyrë të qëllimshme.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës dhe konkretisht shkresës nr. 1597/2 prot., datë 31.1.2025 dhe nr. 1183/1 prot., datë 20.2.2025, nëpërmjet të cilave MAS depozitoi praktikën e aplikantit A.A, të cilit me vendimin nr. 3, datë 26.4.2024, të Komisionit *AdHoc* të Njohjes së Titujve Akademik i është njohur titulli akademik “*Profesor*”, lëshuar nga Universiteti i Tennessee, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe praktikën e aplikantit U.A, të cilit me vendimin nr.6, datë 24.11.2022, të Komisionit *AdHoc* të Njohjes së Titujve Akademik, i është njohur një nga tre titujt për të cilët ka aplikuar, konkretisht, titulli akademik “*Profesor*”, lëshuar nga Universiteti i Shtutgartit, Gjermani, rezulton se procedura verifikuese e zbatuar për aplikimet e ankuesit është zbatuar në të njëjtën mënyrë edhe për aplikantët z.U.A dhe z.A.A.

Bazuar në aktet shkresore të administruara për rastet e A.A dhe U.A, rezulton se, gjatë procedurës verifikuese të zhvilluar nga Sekretariati Teknik i Komisionit *AdHoc*, SENJOD në QSHA, IAL-ve, i është kërkuar i njëjti informacion: në lidhje me autenticitetin e titullit, nivelin e ekuivalentimit të titullit dhe vlefshmërinë në nivel kombëtar të titullit në vendin e lëshimit. Konkretisht:

Në rastin e aplikantit A.A, SENJOD, në QSHA, i është drejtuar IAL-së me këto pyetje:

- *A është diploma bashkëngjitur autentike?*
- *Me cilin nivel është e barazvlefshme?*
- *A ka ky titull vlefshmëri në të gjithë territorin e Sh.B.A? Me fjalë të tjera, a mund të njihet dhe përdoret ky titull nga universitete të tjera brenda SHBA apo jashtë saj, apo është i vlefshëm vetëm brenda Universitetit të Tennessee?*
- *A është titulli i regjistruar në regjistrin kombëtar të titujve akademik në shtet (nëse ka një regjistër të tillë)?*

Në rastin e aplikantit U.A, SENJOD, në QSHA, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit *AdHoc*, i është drejtuar IAL-ve, me këto pyetje:

- *A është diploma bashkëngjitur autentike? A është dokumenti bashkëngjitur equivalent me titullin “Profesor”?*
- *Me cilin nivel është e barazvlefshme?*

- *A ka ky titull vlefshmëri në të gjithë territorin e Gjermanisë?*
- *A është titulli i regjistruar në regjistrin kombëtar të titujve akademik në Gjermani?*

Ankuesi pretendon se arsyet e mosnjohjes së dy titujve të tij janë të pabazuara si në legjislacionin e brendshëm ashtu edhe nga legjislacioni ndërkombëtar, Konventa e Lisbonës dhe se në rastin e tij është bërë një zbatim selektiv i ligjit.

Në lidhje me titullin Diplomë *Venia Docendi/Privatdozent*, lëshuar më datë 30.6.2020 dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër, pala ankuese pretendon se, nuk ka asnjë pengesë ligjore për njohjen e titujve që nuk kanë ekuivalent të drejtpërdrejtë në praktikën e brendshme, përkundrazi është detyrim ligjor njohja e titujve të fituar në një universitet të huaj. Komisioni *AdHoc* për Njohjen e Titujve Akademikë ka për detyrë që të vlerësojë përputhshmërinë e kriterëve akademike, jo të mohojë njohjen për mungesë të ekuivalencës në emërtesë. Sipas ankuesit, titulli akademik “*Docent*” i lëshuar nga Universiteti i Bernës është ekuivalent me të paktën titullin akademik “*Profesor i asociuar*”.

Në lidhje me titullin “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër, pala ankuese pretendon se, vlefshmëria në kohë e një titulli nga një universitet është irelevante për procesin e njehsimit, dhe kërkesë jo ligjore, pasi legjislacioni shqiptar për njehsimin e titujve akademikë nuk e kushtëzon njohjen në bazë të kësaj. Titulli “*Profesor i asociuar*” i dhënë nga Universiteti i Bernës ka vlefshmëri të kufizuar në kohë për këtë Universitet, por vlefshmëria e tij në një universitet tjetër brenda Zvicrës ose jashtë saj, vlerësohet rast pas rasti, nga kriteret e brendshme. Ligji shqiptar njeh vlefshmërinë e titullit për të gjithë jetën. Pavarësisht dhe për më tepër, në kohën e aplikimit deri brenda afatit 45 ditor, kur duhej të ishte kryer procedura e njehsimit, titulli akademik ka qenë i vlefshëm.

Ankuesi pretendon se, është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në krahasim me raste të tjera të ngjashme, siç është rasti i Prof. A.A, ku i njëjti Komision *AdHoc* me vendimin nr.3, datë 26.4.2024, ka njehsuar titullin akademik “Profesor”, lëshuar nga Universiteti i Tenesit, kur edhe në Amerikë vlefshmëria e titullit është e lidhur me afat. Sipas ankuesit, praktika të ngjashme me rastin e Prof.A.A, janë bërë edhe për raste të tjera, ku nga viti 2021 janë njësuar nga 13 tituj akademik *Profesor* dhe *Profesor i Asociuar* nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia, vende të cilat i kanë titujt akademik të lidhur me vendin e punës të ngjashëm me praktikën në Zvicër.

Bazuar në përcaktimet e ligjit nr.80/2015 dhe VKM nr.112/2018, të ndryshuar, rezulton se, titulli akademik i fituar në një universitet në Republikën e Shqipërisë ka vlerë ligjore dhe është i transferueshëm në të gjitha institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari akademike në Republikën e Shqipërisë, pra ka një vlefshmëri në të gjithë territorin e vendit dhe nuk është i kufizuar në kohë. Në këtë kuptim, vlefshmëria në kohë dhe në hapësirë e titullit akademik, janë dy kriteret thelbësore që parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi.

Sipas legjislacionit në fuqi njohja e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, bëhet sipas përcaktimeve të ligjit për Arsimin e Lartë, në rastin konkret ligjit nr.80/2015 dhe sipas parimeve

dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare.

Konventa e Lisbonës, nuk parashikon se një shtet është i detyruar automatikisht të njohë titullin akademik të fituar jashtë vendit, nëse ato nuk përputhen me legjislacionin e tij kombëtar. Në nenin VI.1, të ëksaj Konvente përcaktohet se: *“Në rastet kur një vendim njohjeje bazohet mbi njohjet dhe dijet e vërtetuara nga një kualifikim i arsimit të lartë, secila Palë njeh kualifikimet e arsimit të lartë të dhëna nga një Palë tjetër, me përjashtim të rasteve kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet kualifikimit të cilit i kërkohet njohja dhe kualifikimit korrespondent në Palën në të cilën kërkohet njohja.”*

Në kushtet kur:

- Titulli akademik “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, nga Universiteti i Bernës, Zvicër, ka qenë i kufizuar në kohë, pra ankuesi ka patur të drejtën ta përdorte këtë titull për aq kohë sa ishte i punësuar në Universitetin e Bernës, Zvicër (1 dhjetor 2020 deri më 30 nëntor 2023, sikurse konfirmohet nëpërmjet emailit të datës 28.2.2024, dërguar nga adresa xxxxxxx@unibe.ch);
- Titulli akademik “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, nga Universiteti i Bernës, Zvicër, është i lidhur me institucionin që e ka lëshuar dhe nuk mund të përdoret më, pas largimit nga ky universitet, pra me largimin e ankuesit nga Universiteti i Bernës, Zvicër, ky titull nuk mund të përdoret më prej ankuesit (sikurse konfirmohet nga email datë 07.03.2024, nga adresa: xxxxxxx@be.ch dhe emaili datë 28.2.2024, dërguar nga adresa: xxxxxxx@unibe.ch), pra nuk ka vlefshmëri kombëtare në shtetin zviceran.

rezulton se, ky titull akademik nuk përmbush dy kritere thelbësore të titujve akademik sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, vlefshmërinë kombëtare dhe vlefshmëri të pakufizuar në kohë.

Me shkresën nr. 1597/2 prot., datë 31.1.2025, MAS depozitoi praktikën e aplikantit A.A, të cilit me vendimin nr. 3, datë 26.4.2024, të të njëjtit Komisionit *AdHoc* të Njohjes së Titujve Akademik, ndryshe nga ankuesit, i është njohur titulli akademik “*Profesor*”, lëshuar nga Universiteti i Tennessee, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ankuesi pretendon se i ndodhur në të njëjtat kushte me aplikantin A.A, atij nuk i është njohur titulli akademik “*Profesor i Asociuar*”.

Nga shqyrtimi i praktikës së vendour në dispozicion, rezulton se, ankuesi nuk gjendet në të njëjtat kushte me aplikantin A.A, sepse IAL-ja që ka lëshuar titullin akademik për A.A, ka informuar SENJOD në QSHA, se titulli akademik “*Profesor*”, lëshuar nga Universiteti Tennessee, në SHBA, ka vlefshmëri kombëtare dhe mund të përdoret nga A.A edhe në universitetet e tjera në SHBA.

Nëpërmjet shkresës nr. 1183/1 prot., datë 20.2.2025, MAS depozitoi praktikën e ndjekur për rastin e aplikantit U.A, aplikim ky që i përket vitit 2022. Nga shqyrtimi i praktikës së vendosur në dispozicion, rezulton se, aplikanti U.A, ka aplikuar për njohjen e tre titujve akademik “*Profesor*” dhënë nga: Universiteti i Kassel, 1984-1988; Universiteti Wurzburg, 1988-1992 dhe Universiteti Shtutgart, 1992 - 2012, në Gjermani. Në përfundim të procedurës, aplikantit U.A me vendimin nr.

6, datë 24.11.2022, të Komisionit *AdHoc* të Njohjes së Titujve Akademikë, të ngritur me urdhrin nr. 659 datë 4.11.2022, të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, i është njohur vetëm titulli akademik “*Profesor*”, lëshuar nga Universiteti Shtutgart, Gjermani, për të cilin konfirmohet vlefshmëria në të gjitha universitetet në Gjermani. Nga praktika e administruar rezulton se, dy titujt e tjerë të aplikantit U.A, nuk janë njohur, pasi nuk është konfirmuar vlefshmëria (kombëtare) e tyre në të gjitha universitete në Gjermani.

Në këto kushte, rezulton se, ankuesi nuk gjendet në të njëjtat kushte me aplikantin U.A, sa i takon titullit “*Profesor*”, lëshuar nga Universiteti i Shtutgartit, titull akademik i cili është njohur nga Komisioni *AdHoc*, pasi për këtë titull është konfirmuar vlefshmëria kombëtare e titullit akademik të njohur. Konstatohet se, Komisioni *AdHoc* i Njohjes së Titujve Akademik, i ngritur pranë MAS, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse në rastin e ankuesit, duke mos njohur dy titujt e tjerë “*Profesor*” të aplikantit U.A, respektivisht dhënë nga Universiteti i Kassel, 1984-1988; Universiteti Wurzburg, 1988-1992, pasi gjatë procedurës verifikuese të realizuar nga Sekretariati Teknik, nuk rezulton të jetë konfirmuar vlefshmëria e tyre në kohë dhe në të gjitha universitetet në Gjermani.

Praktikat e mësipërme provojnë se, njohja e titujve akademikë të lëshuar jashtë vendit, është kushtëzuar në të njëjtën mënyrë sikurse në rastin e ankuesit, nga vlefshmëria në kohë dhe në hapësisë e titullit akademik. Praktikat e administruara i përkasin vendeve të cilat sipas ankuesit pretendohet se kanë një sistem të ngjashëm sikurse vendi që ka lëshuar dy titujt e tij, Zvicra. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nëpërmjet *emailit* të datës 25.11.2024, të QSHA, rezulton se nuk është njohur asnjë titull akademik, i lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë në Zvicër.

Në lidhje me titullin *Docent/Diploma Venia Docendi/Privatdozent*, lëshuar më datë 30.6.2020 dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër, rezulton se një titull i tillë, nuk njihet në bazë të ligjit nr.80/2015 dhe se ky ligj, por edhe udhëzimi nr.21/2021, nuk përcaktojnë procedurë njohje për këtë titull.

Referuar nenit 92, të ligjit nr.80/2015, konstatohet se, ligji ka bërë një diferencim midis njohjes së diplomave, certifikatave e gradave dhe njohjes së titujve akademikë të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë. Në rastin e diplomave, certifikatave e gradave shkencore, dispozita ligjore përdor termin “*njohje dhe njesim*” ndërsa në rastin e titujve përdor termin “*njohje*”.

Njohja e kualifikimeve të fituara jashtë vendit nuk është automatike, pra jo çdo titull i lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, mund të njihet. Nga ana tjetër njohja e titullit akademik të fituar jashtë vendit realizohet sipas ligjit për Arsimin e Lartë, që në rastin konkret është ligji nr.80/2015.

Procedura e njohjes së titujve akademikë bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.21, datë 15.10.2021, të ndryshuar dhe ky i fundit nuk përcakton ndonjë detyrë për Komisionin *AdHoc* të Njohjes së Titujve Akademik, që të vlerësojë përputhshmërinë e kriterëve akademike të titullit për të cilin kërkohet njohja me kriteret për fitimin e titujve akademikë, sipas VKM-së nr.112, datë 23.2.2018, të ndryshuar.

Sa më sipër, rezulton se, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, Komisioni *AdHoc* për Njohjen e Titujve Akademik, i cili ka marrë në shqyrtim aplikimin e ankuesit nuk ka patur detyrimin që, në mungesë të njohjes së një titulli të tillë sipas ligjit nr.80/2015, të vlerësojë përputhshmërinë e kriterëve akademike për fitimin e titujve akademikë sipas VKM-së nr.112, datë 23.2.2018, të ndryshuar dhe të vlerësojë nëse titulli akademik *Docent/ Diplomë Venia Docendi/Privatdozent*, lëshuar më datë 30.6.2020 dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër, është ekuivalent me të paktën titullin akademik “*Profesor i asociuar*”. VKM-ja nr.112, datë 23.2.2018, e ndryshuar, përcakton kritere dhe procedurën që duhet të ndjekin IAL, si autoritete të cilave ligji nr.80/2015, i ka njohur të drejtën e lëshimit të titujve akademik.

Gjithashtu, rezulton se, emërtesa “*Docent*”/*Diplomë Venia Docendi/Privatdozent*”, nuk parashikohet në kuadër të gradave shkencore, të njohura sipas ligjit nr.80/2015.

Gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ që ankuesi ka paraqitur në lidhje me mosnjohjen e dy titujve akademikë, bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara, nuk rezulton që ankuesi të ketë depozituar pranë Komisionit *AdHoc* të Njohjes së Titujve Akademikë, të ngritur për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga ana e tij, sipas urdhrin nr. 355, datë 10.7.2024, fakte dhe prova, në funksion të njohjes së titujve akademikë dhe rrjedhimisht me të drejtë me vendimin nr.1, datë 11.7.2024, Komisioni *AdHoc* ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.7, datë 26.4.2024 për mosnjohjen e titujve akademikë. Gjithashtu rezulton se, tre nga katër anëtarët Komisionit *AdHoc* që ka marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur nga ankuesi, kanë ndryshuar, krahasimisht me Komisionin *AdHoc*, që ka marrë në shqyrtim aplikimet e ankuesit.

Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi T.M nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me mosnjohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, *Diplomë Venia Docendi/Privatdozent*, lëshuar më datë 30.6.2020 dhe titullin “*Profesor i Asociuar*” lëshuar më 1.12.2020, dhënë nga Universiteti i Bernës, Zvicër. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit z. T.M , për shkak të bindjeve politike dhe

gjendjes arsimore, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe znj. O.M , Ministre e Arsimit dhe Sportit.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike, gjendja arsimore
Fusha: Arsim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim